



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

31-10-2022

Formulari i Përdorur në Datë			
Nr. i Organizatës Lokale	Komuniteti	Shtetësi	Vlera
Org. lokale		Prillig	Vendnost

01-110/05-1228



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, neni 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.10.2022, merr këtë:

## V E N D I M

**për miratimin e procesverbalit nga mbledhja tetë e Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 28.09.2022**

### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë, miraton vendimin për procesverbalin nga mbledhja e tetë e Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 28.09.2022

### Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është procesverbali i datës 29.09.2022.

### Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

K R Y E S U E S I

Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË TETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 28.09.2022 (e Mërkure) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, Kryetari i komunës z.Sokol Haliti, nënkryetari, z.Hasan Aliu si dhe këshilltarët e Kuvendit: Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredini, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Jakup Demiri, Liridona Bislimi, Sejdi Emiri, Nexhat Halili, Majlinda Shabani, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Veton Ramadani, Vilsona Maliqi-Salihu, Zyrafete Rama, Anisë Zejnullahu, ndërsa mungoj Reshat Azizi. Sokol Shaqiri, Taibe Ibrahim

Pasi u konstatua se prezent janë 24 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Të nderuar të pranishëm, kryetar, nënkryetar, këshilltar, përfaqësues të mediave, mirë se keni ardhur në seancën e tetë të rregullt. Sot është data e 28.09.2022, dita e ramjes së dëshmorëve Gursel e Bajram Sylejmani. Ne se bashku me ekzekutiven komunale do të dalim e të bëjmë homazhe tek busti që e kemi këtu para shtëpisë së kulturës. Fjalën ja kaloj kryetarit të komunës.

**z.Sokol Haliti, kryetar i komunës:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sot është një ditë e veçantë, dita e ramjes së dëshmoreve Gursel e Bajram Sylejmani. Kërkojmë nga ju ta mbajmë një minut heshtje dhe të dalim të bëjmë homazhe tek busti.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Fillojmë me punimet e seancës. Ju njoftoj që kemi pranuar konfirmimin e ligjshmërisë nga ana e MAPL-së. Gjithashtu ju njoftoj që ne në seancën e jashtëzakonshme kemi nxjerr një deklaratë, e ku ju kemi dergu Ministrisë së Arsimit, e ministria na njofton lidhur me procedurat rreth projektit të shkollës “Halil Alidemaj” në Pozheran dhe ndërtimin e çerdhes së fëmijëve në Viti. Kryesuesi e lexoj përgjigjen e dhënë nga Ministria e Arsimit. Për këtë seancë materialin e keni marr me kohë dhe jemi përgatit për këtë seancë. Fillimisht e kemi deklarimin jashtë rendit të ditës. Kërkoj të respektohet koha e gjuha e komunikimit. Hapim diskutimin jashtë rendit të ditës.

**z.Illir Zuka:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kam një pyetje për drejtoreshën Fatbardhë. Ne i dimë krejt procedurat, kontrata ka pas me u nënshkru me 14. A keni ndonjë informatë, çka ka ndodhë me atë? Edhe e dyta, për drejtoreshën Merrushe. Keni bërë marrëveshje me disa ordianca private. Vetëm po të tregojë se, është shkëlqej e ligjit. A keni informatë me na dhanë, se, pse keni nënshkru kësi marrëveshje.

**z.Ali Bajrami:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë e kisha një kërkesë, që takimet përpos komunitetet obligative që kanë qenë, Komiteti për Financa, Komiteti për Komunitete, komunitetet që janë

formu për arsim, shërbime publike, e të tjera, që të publikohet në web faqen e komunës, se janë funksionale. Kërkesën tjetër e kam, nuk e di tash a është në kompetenca të komunës apo jo. Te Zyra e Pensioneve që funksionon në QPS, në kuadër të Komunës së Vitisë, ajo zyre në katin e dytë, kur e dimë që çfarë strukture duhet me shku e me u paraqitë atë maltretim, me ja u bë me hypë ne katin e dytë. Mundësisht me bë një zgjidhje me bë për në katin e parë, sepse kam qenë vet dhe i kam pa vështirësitë.

**z.Taulant Haxhiu:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Pasi që sot qenka prezent nënkryetari, e kryetari nuk është këtu, kam një pyetje. Hidrocentrali te Shushtë ka fillu në vitin 2015, kur ju keni ardh në pushtet dhe ende nuk është përfundu. Me ditë se ku kanë mrrri punët. Kam pyetje tjetër. Parku i biznesit edhe ai ka shku gjatë. Kur do ta dinë qytetarët, bizneset e Vitisë, që do të finalizohet? Do të fillojnë aty bizneset të veprojnë? Zakonisht projekte e mëdha i keni dy mandate që i keni përfundu në qeverisje. Këto i keni vetëm për marketing, kurse projektet e vogla i kryni, e këto të mëdhajat jo. Këto janë projektet më të mëdha që ka pas ndonjëherë Komuna e Vitisë. Që 7 vite hidrocentrali, që 4 vite parku i biznesit. Nuk po kemi asgjë definitive. Faleminderit!

**znj.Liridona Bislimi:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Deshta me u ndërlihd edhe me temën që e diskutoj kolegu. Te web-faqja zyrtare duhet të bëhet një rifreskim i emrave të këshilltarëve komunal që janë zgjedhur tani në komunitetet aktuale. Pra qytetarët e kanë parë se nuk është në dijeni, se cili nga ne i takojnë komiteteve për shkak se momentalisht emrat e këshilltarëve të mandateve te kaluar janë të pozicionuar në web-faqe. Pra, duhet bëhet një rifreskim dhe te vendosemi ne qe jemi tani. Kam një pyetje për drejtorin e arsimit, lidhur me transportin e nxënësve të shkollave të mesme ne fshatrat rurale të Komunës se Vitisë. Ne e dimë që kemi ngritur këtë shqetësim edhe viteve paraprake dhe e dimë që një përgjigje që e kemi marrë, që është e vështir, por besoj që duhet të gjendet një modalitet për të participuar në vazhden e këtyre shpenzimeve. Në të kundërtën, drejtoresh, kostoja do të jetë braktisja e fshatrave ashtu edhe si ka filluar, siç kam potencuar edhe disa here në diskutimet e mia ka prindër që nuk mund të shkojnë në punë, për shkak se duhet ta dërgojnë fëmijën e tyre në shkolla dhe t'i marrin kur të dalin dhe kjo e përkeqëson gjendjen ekonomike dhe ata detyrohen ta braktisin edhe fshatin. Gjithashtu më intereson ta dijë, KDI gjatë viteve të kaluara nuk jam e saktë, 2019 më duket në 11 shkolla të Komunës së Vitisë, aty ku ka bërë teste në 10 prej tyre ka dalë që fëmijët tanë furnizohen me ujë me kontaminime bakteriologjike dhe kimike. Pra, më shumë se 1500 nxënës kanë qenë duke u furnizuar me këtë ujë. Më intereson ta dijë se, çfarë keni ndër marr, pasi e dimë që mësimi shumë shpejtë nëpër shkolla do të fillojë dhe prindërve ju intereson ta dinë, nëse fëmijët do të vazhdojnë të furnizohen me ujë të tillë. Njashtu edhe një problem shumë i madh nënkryetarë, është me ndriçimin publik, siç e kemi potencuar nga këshilltarët komunal. Kemi fshatra që ndriçimi publik nuk ndalet edhe ditën, ndërsa kemi fshatra që ndriçimi publik kanë probleme të vazhdueshme. Nuk dua të potencoj me emra, mirëpo një numër i madh i fshatrave tek banorët tanë kanë probleme të vazhdueshme me ndriçimin publik.

**z.Musli Neziri:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Në mbledhjen e 3-të të këtij viti, në mbledhjen e këtij kuvendi kam pas kërku që, pjesa e rrugës "Rexhep Bislimi" deri sa e rrokë me regjion të Kllokotit, të shtrihet. Atëherë e kam bë si kërkesë, rrjeti i kanalizimit, ujësjellësi, ndriçim dhe trotuar, meqenëse frekuentojnë bizneset, tanimë në këtë kohë që po flasim është kry një pjesë e fazave të para e kanalizimit është lidhë një pjesë e lagjeve aty që mendojë që është bërë mirë një pjesë afër QKMF-së, por një pengesë është parë që, gjatë kryerjes së punëve punimet janë ndërpre te Mediterani. Domethënë nuk kanë vazhdu sa e rrokë pjesa e Kllokotit. Mua më pëlqej kjo iniciativa e kryetarit që, do të bashkëpunojë me Komunën e Kllokotit, se, tek e fundit jemi në zonë kadastrale me ta, por aty janë ndërpre punime dhe është kry vetëm pjesa e kanalizimit deri te Mediterani, nuk janë kry as ujësjellës, as ndriçim. Çka nëse në të ardhmen ndodhë shumë në kohë të shkurt që të bëhen prapë punim aty dhe aty kanë has në probleme gjatë kryerjes së pjesës së parë të kanalizimit për arsye se bizneset po dëmtohen ne kyqje po dëmtohen në hyrje. Domethënë ju shkakton telashe pse nuk është kry faza gjitha që thamë, domethënë ujësjellës dhe ndriçim që mos të bëhen punë çdo vit aty mu punu nga pak. Domethënë në mbledhjen e 3-të e kam pas ngritë këtë çështje. Më vjen mirë që është bë ky projekt, por nuk

është kry deri në fund, është ndërpre, jemi dëshmitarë të kësaj, ndërsa pyetjen e dytë e kam për drejtoreshën e arsimit. Gjatë muajve të Verës ose pushimeve, kemi pa se janë kry disa renovime nëpër shkolla, që janë të nevojshme, kuptohet, por a janë kry të gjitha shkollat që kanë pas nevojë, domethënë a keni dalë në teren me pa sa shkolla kanë mbet ose si janë përzgjedh ato që me u renovu, meqenëse parafolësi tha se mësimi do të fillojë së shpejti. Unë thamë se, mësimi është tu humb, jemi të gjithë dëshmitarë të saj, prandaj te punimet, renovimet e shkollave: a janë kry të gjitha po më intereson?

**z.Nexhat Halili:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam një pyetje rreth rregullimit të trotuareve dhe ndriçimit publik. Kontrata është e lidhur me 27.10.2021 me numër protokoli. Tjera kontrata, 720 mijë e 153 e 13, afati i kontratës është 2 vjeçar. Në seancën e 3 ose 4, unë kam bërë pyetje rreth trotuarit, i cili lidh fshatin Trestenik me Sllatinë dhe Sodovinë. Përgjigjja e kryetarit të komunës ka qenë se, brenda 1 muaji do të fillon ky trotuar dhe në anë të saj dhe do të më ftojë në solemnitetin të cilin do ta bëjë. Ende deri tash nuk ka fillu ky trotuar. Kur do të fillojë trotuari, i cili i lidhë 3 fshatrat dhe i cili është i nevojshëm sidomos për nxënësit e këtyre lokaliteteve? Në kuadër të ndriçimit publik ka edhe shumë lagje të tjera, ku nëpër fshatra të ndryshme të cilat nuk kanë ndriçim publikë po e potencojë edhe rrugën kryesore në fshatin Sodovinë të Muhaxherve e cila nuk ka ndriçim publikë: Kur ka me u rregullu? Besoj që ndriçimi publik nuk është diçka që do të kushtojë shumë. Edhe tjera, trotuari prej Sodovines së Muhaxherve dhe Sodovinës së Jerlive kanë met mes, nuk është shtru. Pyetja tjerët, edhe një e kam. Te rruga “Ali Muhaxheri” në fshatin Trestenik. Kjo rrugë nuk është e madhe, është dikun rreth 290 metra, nuk besoj që kushton shumë. Tash është ofru sezona dimërore, është rrugë jashtë normales: kur do ta shtroni edhe këtë rrugë? Dhe një sugjerim tjetër e kam, te web faqja e komunës, deri diku para 2-3 muajve, gjitha publikimet e kontratave janë publike, qe 2-3 muaj nuk janë tu u publiku në web faqet e komunës kontratat e nënshkuara, sidomos prej prokurimit publik. Publikimet tjera, njoftimet për kontratë, njoftime për dhënien e kontratës, njoftimet për anulime janë të publikuara vetëm kontrata nuk janë tu publiku.

**znj.Majlinda Shabani:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Fillimisht i kamë 3 pika kryesore e para ka të bëjë me një propozim, e cila lidhet me drunjet e konfiskuar nga pylltaria në Viti. Propozim që me ju dhuru familjeve në nevojë. U përmend shumë çështja tek arsimit, transporti, mirëpo edhe riparimet që janë bërë neper shkolla e dijmë problematiken që e kem pas me inveratin e vjetër nëpër shkolla deshta me pyet drejtoreshën se a është marr hapa drejt zgjidhjes së këtij problemi. Gjithashtu gjatë muajit Shtator bashkë me të rinjtë e Komunës se Vitisë kemi zhvillu një aktivitet tek stacioni i autobusëve në Viti, ku realisht kam parë gjendjen e stacionit qysh është. E dimë që është investim shumë vite më parë, mirëpo asnjëherë nuk është shfrytëzu nga komuna edhe nga qytetarët e saj. Po du me ditë se, çfarë ka me ndodh me stacionin e autobusëve në Viti dhe pse nuk është në shfrytëzim nga komuna?

**z.Remzi Salihu:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam një pyetje për drejtoreshën e arsimit, lidhur me punësimin. Punësimi në Komunën e Vitisë u bë tejet problematik, po i cili shumë rrallë po diskutohet se si bëhet punësimi në Komunën e Vitisë. Besoj që e dini të gjithë, po nuk do të ndalem aty, do të shkoj konkretisht sipas informatave po e thamë jo të verifikuara, po informata që me kanë ardh, bëhet fjalë për punësim të punonjësve në arsim. Drejtoreshë, s’po du me hy në detaje, po vetëm pyetja: a ka kandidat të cilët kanë marrë pjesë në konkurs që nuk janë pranë dhe kanë bërë ankesa, edhe janë refuzu prapë dhe a ka kandidat që kanë marrë pjesë në konkurs dhe janë anku në gjykata? Nëse ka dhe vërehet, gjykata merr një vendim të kundërt me atë që është marr nga komisioni: kush do ta bartë përgjegjësinë? Po flitet se punësimi pikërisht te këto punonjësit arsimor është bërë përmes porosive me sms dhe me dhënie të mitos. Këto nuk i kam informata të verifikuara, por kam informata kësi soji. Dhe tjetra, dashta me shtru një problem që ndoshta nuk është fare i rëndësishëm, po megjithatë unë po kërkoj nga kryetari i kuvendit apo sekretari, që të naj përgatit nga një kartel identiteti të plastifikume, që ta kemi, sepse më ka rastisë, kam qenë dikun në vizitë, dhe pak a shumë

kemi pas fërkime, ja s'të njof, nuk ki dokument. Është mirë me pas. Mund të ketë konfrontime më të mëdhaja, mundësisht të jetë e plastifikume, i kemi pas më herët po janë shly menjëherë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kjo është kërkesë për kuvend dhe është shumë e arsyeshme. Besoj që me sekretarin do ta kryejmë, do të bëjmë nga një kartel indetifikimi si këshilltar komunal.

**z.Sejdi Emini:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! U fol edhe më herët se, punët janë ka zhagiten në disa punë ku kanë fillu të kryhen. Një nder to është edhe puna e trotuarit në fshatin Goshicë, prej nga vij unë. Është një trotuar që ka fillu që një kohë të caktuar, mirëpo punët janë tu shku aq kadal saqë jam i sigurt që secili prej nesh me pas marrë atë trotuar me dy punëtorë kishim mri qaq punë sa është punu deri tash. Puna e cilat po kryhet aty janë tu paraqitë tash edhe pengesa, rreziqe, sepse një njëërën anë zhavorri që e qesin punëkryersit po e rrezikojnë ndoshta edhe komunikacionin në vendbanim ku jemi aty. Një shqetësim tjetër është edhe te privatizimet. E dina që qysh janë bë privatizimet e egra, duke i përvetsu pronat publike. Njerëzit e mdhaj në shtet që i kemi pas, njëra nder to është edhe prona mbi fshatin nga vijë unë, fshati Goshicë, po e rrokë edhe një pjesë të Verbanit, aty është privatizu më herët mbi 60 hektarë, mirëpo tash janë duke u bërë do matje. Kisha dashtë me ditë a ka informacion institucioni komunal që aty po përflitet që kanë me u bë disa punime solare dhe që banorët janë mjaftë të shqetësuar me këtë informacion që e kanë, se ndoshta është në pyetje dhe shëndeti. Nëse paraqet rrezik për shëndetin e banorëve, qytetareve, atëherë është përgjegjësi edhe e komunës po edhe banoreve që jetojnë aty. Nëse keni informacion lidhur me këtë çështje, kisha dashtë që me naj dhanë sot edhe neve si kuvend po edhe banorët të cilët kanë shqetësim dhe interesim.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Këshilltarët kanë bërë pyetje deri tani, besojë që kena shumë pika sa të kemi mundësi me dhanë kapacitetin e potencialin se kemi dhe pika të tjera me rëndësi.

**Drejtoresha e Arsimit, znj.Fatbardha Emini:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! U parashtruan disa pyetje. Do të ishte mirë që unë sot të informoja kuvendin për fillimin e procesit mësimor, se është shtatori e të informoja kuvendin dhe qytetarët për përgatitjet që janë bë për fillimin e procesit mësimor, në ato mundësitë buxhetore që i kemi, sepse jeni anëtare të kuvendit dhe sot e keni në pikë të renditë të ditës edhe buxhetin edhe e shifni në sektorin e arsimit se, cilat investime do të jenë për vitin 2023, e pastaj në 2023 keni të drejtë me më majtë për fjale brenda buxhetit që ju e votoni këtu, por ja që po bëhen 4 javë dhe mësimi ende nuk ka filluar dhe kjo është një gjendje jashtëzakonisht shqetësuese, jo vetëm për neve si bartës të institucioneve, por është shqetësuese me trajtimin që po ju bëhet mësimdhënësve dhe në përgjegjësi sektorit të arsimit, konkretisht nga ana e personave përgjegjës. Në këtë rast nga ana e qeverisë dhe këtu ndoshta nuk është kompetencë e jona, por është kompetencë e gjithë qytetarëve që arsimin ta trajtojmë pakë me dinjitet e mos të merremi aty me cikrrima, sepse edhe shtëpinë tonë që e kemi ndonjëherë nuk kemi mundësi me rregullu në më të mirë të mundshme, sepse edhe ka procedura edhe ka mundësi tjera buxhetore, por po habitem pse një situatë e tillë po kalon në heshtje dhe po habitem se si trajtohen mësimdhënësit dhe situata që jemi ne sot, domethënë nuk është vetëm 1 muaj po janë 4 muaj që fëmijët janë jashtë procesit mësimor. Domethënë nga 6 qershori fëmijët janë jashtë procesit mësimor dhe askush nuk e merr këtë përgjegjësi dhe institucionet tona e kalojnë në heshtje apo me injorancë. Do të doja që sot të ju informoja për përgatitjet që kemi bërë me aq mundësi dhe kapacitet që i kemi si komunë pa mbështetje nga niveli qendrorë. Domethënë kryesues i prezantove 2 pika që me të paren po lidhna në përgjigjen e llirit, që për fat të keq edhe se do të fillonte mësimi, por mësimi në shkollën "Halil Alidema" rapë do të jetë me një shkurtim të orëve, por sa për informatë që kam nga drejtoresha e departamentit, procedurat e thirrjes, meqë nuk kanë shku me negociam ashtu qysh kemi kërku ne, me i shpejtu procedurat, por kanë shku me tender të hapur. Thirrja është mbyllur, tash janë në procedurën e vlerësimit, por sipas njoftimit që kam, zyrtarë domethënë përmes shkresave plani dinamikë do të jetë 60 ditë, domethënë 2 muaj, Tash urojmë që mos të ketë afat të ankesave pas vlerësimit dhe të fillojnë punimet të shkollës "Halil Alidema". Transporti për nxënësit të fshatrave malor, të them te drejtën është shumë shqetësuese, jo vetëm braktisja e fshatrave po është shqetësuese edhe braktisja e vet Kosovës. Po ju njoftoj, janë 12 mësimdhënës që e kanë lëshuar procesin

arsimor, kanë shku jashtë një situatë e tillë nuk është vetëm në vise malore po është në komplet vendin edhe kjo duhet me u trajtu dhe nuk duhet me i dhanë aspak ngjyrim politikë por ne vitin e kalum edhe vitet e kaluara e kemi pas një memorandum për shkak se arsimit i mesëm nuk është obligativ, ne jemi tu e shiku mundësinë nëse kemi raste të tilla përmes subvencionimit, kemi pas raste edhe vitin e kaluar që i kemi subvencionin nxënësit e shkollës mesme, të cilët kanë bërë më shumë se 10 ditë apo 2 javë dhe e kanë paraqitë pengës transportin në vise. Domethënë kemi subvencionu këtë kategori, do ta subvencionojmë prapë dhe aspak nuk jemi për me u braktis edhe arsimit i mesëm pavarësisht që nuk është obligativ dhe nuk është brenda kompetencave tona ligjore që jemi të obligum, por jemi kompetent për me ofru arsim parauniversitarë për të gjithë kategoritë, uji i pijshëm, dorën në zemër duhet me kuptu që në ato lokalitete ku nuk ka ujësjellës uji i pijshëm përmes puseve ndryshon me një të reshur. Ne pavarësisht që e bëjmë klorizimin tepër shpesh të shkollave të ujit, ajo mund të ndryshojë nëpër pusët tona, kështu që në ato lokalitete ku nuk ka ujësjellës duhet me kuptu që uji nuk është i pijshëm as në hapësirat shkollore. Nxënësit janë të njoftuar, njoftimet janë në secilën shkollë, se uji është i pijshëm në ato lokalitete. Ne po bëjmë përpjekje. E dini problemin e ujësjellësit siç është ajo marrëveshje me CDI, ndoshta nënkryetari mund të na njoftojë edhe më shumë sa i përket këtij informacioni. Renovimi i shkollave, kontrata është 2 vjeçare, nuk do të thotë që janë kry të gjitha punët sipas kontratës, kryhen në bazë të mundësive buxhetore që i kemi pas për këtë vit, domethënë ato që kanë qenë me prioritet i kemi përfundu dhe të tjerat do të kryhen në pushimin e Janarit, për shkak se janë punë të brendshme e kemi planifikuar ashtu edhe me menaxherin e kontratës. A ka nevojë me u punu, natyrisht që ka, se janë 39 shkolla dhe me këtë buxhet që e kemi pas për këtë vit ndoshta me u pas përqendru vetëm me 1 dhe 2, që ka nevojë nuk kishim mujte me realizu, por për fat të mirë pas kërkesës që e kamë pas te kryetari, e shifni edhe në planifikimin buxhetor është trefishu buxheti për vitin e ardhshëm dhe kemi mundësi me punu shumë më shumë vitin e ardhshëm edhe në rivitalizim të shkollave, edhe të çerdheve dhe në rivitalizim të përgjithshëm infrastrukturor në hapësirat shkollore. Inventari i shkollave. Është formu komisioni, janë duke punu, kanë bërë një plan dhe kanë fillu me 3-4 shkolla deri më tani kanë caktu lokacionin ku kanë me bartë këtë inventar, pastaj në bazë të procedurave që kërkohet, sepse ky inventar duhet me u qitë në ankand dhe me u shitë inventari i pa përdorshëm nëpër shkolla. Vetëm kanë fillu dhe e kanë shfryzu edhe këtë kohë të shtatorit me punu me një plan pak më të shpejtë. Punësimet më vjen tepër jashtëzakonisht keq kur e dëgjojë një fjalë prej një profesori, e sidomos shpifë publikisht në kuvendë komunal. I nderum, nëse ju keni fakte dhe dëshmi ju kisha lutë ti depononi aty ku e kanë vendin. Po ashtu mundeni me pyet kryetarin e forumit rinor të juvin, Arbnor Ademin, a i ka dhanë dikujt apo jo. E dyta, procedurat janë publike dhe zhvillohen nga zyra e burimeve njerëzore dhe lista është publike kush është pranë. Dhe sa për informim, unë nuk di që ka ndonjë ankesë, por nëse ka, ajo shkon përmes procedurës gjyqësore dhe gjithmonë e kemi respektu çdo procedurë gjyqësore që është zhvillu. Tani për tani e dini, mbi Ligjin mbi Zyrtarët Publik jemi ndoshta prej të paktë komuna që zbatojmë Ligjin mbi Zyrtar Publik dhe nuk kemi dashtë si drejtori e arsimit me u ngarku edhe procedurën e punësimit po zhvillohen te Zyrtar e Burimeve Njerëzore me një transparencë konsideroj. E di që kërkesat për punësim janë jashtëzakonisht të mëdhaja, dhe dikush nga mos realizimi i kërkesës mund edhe të shpif, por nëse ka ndodhë një rast i tillë, unë të lusë profesorë, bashkë me mu shkojmë e denoncojmë rastin. Bash jam e interesime me bërë një gjë të tillë, kështu që tu kisha lutë jo me fol këtu po me deponu dëshminë aty ku duhet, sepse me një retorikë të tillë ne sot po vuajmë dhe nuk kemi mësim qe 1 muaj ditë dhe ne sot po vuajmë fshatrat po braktisin, sepse nuk ka shpresë në këtë vend tu u ndertu një retorikë e tillë e politikave shpife.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit! Drejtoresha sot e ka pas edhe me planin e kuvendit komunal me pru informatë për gjendjen në arsim, mirëpo unë nuk e kam pranë në këtë seancë, për shkak të pikave shumë që i kemi pas, e kemi lënë për seancat tjera. Drejtoreshë, pasi që jemi te arsimit, në kuadër të punëve që janë tu u kry te shkolla e vjetër teknike, është largu kulmi, janë tu u dëmtu pjesa e makinave çka janë në punëtori dje

kemi marrë do masa edhe ne mësimdhënësit kemi shku aty, mirëpo është mirë me pas kujdes së paku deri sa të bëhet kulmi, me ju bë një presion më shpejt për shkak me i ruajt këto mjete.

**Drejtoresha e Arsimit, znj.Fatbardha Emini:** Faleminderit shumë kryesues! Unë sinqerisht shumë kam dëshirë me pas një menaxher të infrastrukturës në kuadër të Drejtorisë së Arsimit edhe ka me bë të pamundur një inxhinier, qoftë arkitet qoftë konstruktiv, çfarëdo qoftë për vitin e ardhshëm se janë 39 shkolla, shumë investime. Edhe unë e kam një debat të jashtëzakonshëm me menaxhera, sepse ata janë të ngarkum me punë të tjera infrastrukturore dhe punë të tjera, ndërsa shkollat kanë plan pak më të shpejtum, dinamik dhe nuk mujm me pritë dikan derisa të vjen atje edhe përgjegjësia pastaj po më bartet mu, se a po e shifni ju pyetjet m'i drejtoni mu, pse nuk është përfundu një punë. Ndoshta unë hiq se marrë veshë këtë aspektin infrastrukturor. Te shkolla e mesme e vjetra, teknika, aty kanë me u bë 2 investimet e para. 1 investim është participim i komunës me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, që e keni pa para 2 dite. Është investim i qeverisë, i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, që kemi apliku për atë grand dhe jemi participim. Është projekt 2 vjeçar që kanë me u rregullu pjesa inovacioni e praktikës së nxënësve me lidhë me tregun e punës. Edhe investimi tjetër është që, ka apliku shkolla te Qeveria Gjermane, është kredi që janë 6 shkolla në krejt Kosovën, një prej tyre është shkolla e mesme profesionale, që unë e përgëzoj edhe menaxhmentin edhe komplet ekipe që i kanë ndihmu me e përfitu. Edhe aty është një vlerë mbi 500 mijë euro. Domethënë për 2 vite në shkollën e vjetër kanë me u investu mbi 1 milion euro. Kjo është jashtëzakonisht e mirë me i përgatit të ritë me kompetencë për tregun e punës, por a ka hapësira për përmirësime, unë normal e themë që ka, dhe do ta shqyrtojë me menaxherin e kontratës që është.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nuk e di sa më kuptove. Unë veç e pata fjalën te masat, te preventivat aktuale që janë tu u kry. Unë mendoj që edhe 2 javë 3 me ndodhë kjo gjendje me ra shi ka me na dëmtu makinerinë. Kjo është veç makinat me i rujt, kjo pjesa urgjente kemi marrë masa ne mësimdhënësit.

**Drejtoresha e shëndetësisë, znj.Merrushe Ahmeti:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Fillimisht faleminderit për pyetjen Ilir. Pe vërej gatishmërinë tënde në dobi të shoqërisë. Marrëveshjet janë bë me një vullnet shumë të mirë faktikisht unë nuk njoft ligj në botë që e mohon me kriju kushte edhe me qenë në dobi të shoqërisë. Përkundrazi, ligji ndëshkon edhe mos veprimin në aspekt shoqëror, ndërsa sa i përket çështjeve ligjore në mënyra qysh ka qenë e rregullume, marrëveshje, çështje të tilla, normalisht që mbetemi në bisedime me Zyrën Ligjore, megjithatë ligji është krijuar për me qenë në dobi të shoqërisë, kështu që kur krijohen gjëra të tilla për shoqërinë, nuk shof çështje diskutime, mirëpo aspektet strukturore të marrëveshjes normalisht lë vend për diskutim. Po ashtu në qoftë se dikush prej juve ka ide qysh mundemi me qenë të dobishëm në shoqëri, dera e zyrës sime është gjithmonë e hapur. Edhe unë si Merrushe, si drejtoresh, gjitha mekanizmat ka me i dhanë me i shfrytëzu në mënyrë që me arrit, se në fund të ditës ne jemi për shoqërinë dhe mbi të gjitha nuk është obligim si drejtoreshë, mirëpo e shof obligim si person. Edhe mos me qenë drejtoreshë ne e kemi për obligim secili prej nesh me kriju dobi në shoqëri, në vendin ku jetojmë. Kështu që, çka do që keni ide në të mirën e qytetarëve, në qoftë se ka arsyeshmëri jeni të hapur me ardh te zyra ime dhe krejt çka do që kam unë si Merrushe në radhë të parë ka me i shfrytëzu krejt mekanizmat. Faleminderit!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Mundësisht ajo zyra që i pranon pleqtë me dalë në katin e parë, kërkesa e Ali Bajramit është jashtëzakonisht me vend me i shiku mundësitë.

**Drejtoresha e shëndetësisë, Merrushe Ahmeti:** Edhe për Zyrën e Pensioneve e kemi parasysh, mirëpo të ju tregojë një informacion, Zyra e Pensioneve nuk është me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Faktikisht është prej ministrisë, edhe meqenëse kur është vendos atje, nuk ka pas vend, strukturë ku kanë mundur me kriju një zyre në komunë, është vendos atje, mirëpo nuk është diçka që përket me drejtorinë teme. Nuk më japin përgjegjësi mua edhe unë ndjej keqardhje kur pleqtë vinë e shofë se unë jam çdo ditë aty. Është faktikisht shumë e dhimbshme, mirëpo nuk është përgjegjësi e jemja, mirëpo nëse mundemi me bë diçka së

bashku po ulemi po diskutojmë, se poshtë janë të gjitha zyrat, zëna dhe secili i ka funksionet e veta, mirëpo ndoshta te komuna e re këna mundësi diçka me bë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Kryesues më lejon të ju përshëndes ty, këshilltarët e kuvendit komunal dhe të gjithë të pranishmit! Fillimisht pasi është organ vendimmarrës, po i burum nga politika edhe kuvendi, më lejoni që subjekti politikë i Lëvizjes Vetëvendosje kaloj me një proces të zgjedhjeve të brendshme, te ju uroj, e pasmi këtu edhe kryetaren e grupit te forumit të gruas dhe të tjerëve dhe të ju urojë suksese në të ardhëm, dhe do të filloja nga pyetja të cilën drejtoresha e dha, që plotësisht e dha në aspektin e rregullimit të përgjegjësive që ajo zyre ka, por pasi që është në objekt tonin ajo zyre është mirë që me u ul me bisedu në rast se kemi mundësi. Metrat katror që ja kemi leju funksionimit të asaj zyre në katin e dytë, me ja dhanë ne katin e parë, se ata i shërbejnë qytetarëve tanë, pavarësisht se llogari i japin në aspekt ministror dhe është çështje të cilën duhet ta shtrojmë dhe besoj që e hasim në mirëkuptim. Unë nuk besoj që në komunë të re ka hapësirë, sepse të gjitha shërbimet, edhe atje në kat të parë janë të zanta. Mundemi me shqyrtu mundësinë, por me të vërtet qytetarët tanë, pleqtë dhe plakat meritojnë një tretman dhe një gatishmëri. Unë e di që ata kanë gatishmërinë me shku edhe në veturë me kry shërbimin, por do të ishte mirë të ju ofrohet në katin e parë. Pat në mesin e tyre edhe tek web-faqja, i përmendet shumë, Alia e përmendi punën e komiteteve, por unë do të ju jap një informacion, se me web-faqen kemi telashe, jo në aspektin komunal, por në aspektin ministror kemi pas telashe edhe unë, kogjo të gjatë, se i kam këtu edhe të Zyrës së Informimit, që e dinë këtë çështje, është një aspekt i defekteve në aspekt ministror. Sa kanë mujt me rregullu, tash e di se kem pas probleme rreth publikimit të njoftimit edhe për planin zhvillimor komunal, por megjithatë janë ato defekte të cilët i kam ngrit edhe kur kam qenë së bashku edhe me kryetarët e komunave që kam marrë pjesë, megjithatë ndoshta është ajo pengesa, mos rifreskimi i kandidatëve të rij të këshilltarëve komunal, të cilët janë sot në kuvend, megjithatë plotësisht pajtohem se duhet me u rregullu edhe ata te cilët janë edhe ata të cilët e bartin këtë mandat përgjegjësive. Pyetjet zakonisht sot kanë qenë pyetje të cilat janë shumë me vend, por megjithatë sikur ka fundi pa ja kushtu ka një poezi nuk po e lajn. Te çështje e hidrocentralit, kuvendi ka dhënë një pëlqim, lejen e merr diku tjetër dhe aty kurrfarë kozmetike aty nuk ka pasur. Ju thatë që projektet e vogla po i kryni për kozmetikë, ndërsa të mëdhajat nuk po i kryni. Unë e kam për obligim më të tregu se i ke bë pyetjet dhe zotnia e ka lejen nga atje, por ma detaje me të tregu deri ku ka ardh mundem me kërkuj prej pronarit dhe në seancën e ardhshme t'i bij. Çështja e zonës industriale të cilën e përmende. Në radhë të parë unë konsideroj që është një e arritur te aspekti i zhvillimit ekonomik, historik për Vitinë, me pru në Viti në mesin e pakë komunave të cilët e kanë dhe ne kemi bërë përpjekje maksimale dhe fati ka qenë që në atë kohë ministrisë së cilës ka qenë përkatëse për këtë çështje ka qenë të anës tonë dhe kanë mujt me na leju një çështje të tillë, megjithatë ne duhet ta kuptojmë që investimi gjithë është i ministrisë dhe sa ato parë lëshojnë aq punimet vazhdoen, jemi në fazën finale. Ne jemi të gatshëm, kemi marr edhe person me kontratë me shërbime te veçanta, mu përgatit për shpalljen e konkursit, thirrjen e biznismenave te cilët janë serioz që me fillu me jetësu atë. Janë edhe disa punë të vogla të cilat nuk janë kry, që pa i lëshu paret ministria atë çështje nuk mundemi me kry. Ndriçimi publik. Liridonë, ne si mekanizëm të veprimit gjithherë nëpër çdo lokalitet i kemi kryetarët e këshillave të fshatit dhe unë besoj se menaxheri që është për përcjelljen e kontratës, që është për rregullimin e ndriçimeve, është shumë i përpiktë në këtë çështje, se e di që 4-5 herë kur kam pas rast mu me më thirr dikush i kamë thanë brenda ditës e ka rregulu. Është mirë me u drejtu kryetari i këshillit te fshatit dhe me i thanë në cilën pjesë me evidentu ai dhe kompania që është përkatëse. Besoj që e rregullon. Unë e di se ka raste të tilla, se mundet me pas defekte, disa nuk ndalen e disa nuk ndriçojnë, por megjithatë duhet të orientohet nga kryetari i këshillit të fshatit, dhe në rast se edhe aty ki probleme, lirishtë thirrem në telefon dhe këtë çështje e rregullojmë. Nexhat, e paske pas marr edhe përgjigjen nga ana e kryetarit, çështja e trotuareve dhe ndriçimeve publike, kanë qenë si kontratë e përgjithshme për krejt lokalitetet dhe unë nuk e kamë pas atë kënaqësi, nuk kam qenë i kënaqur me punët të cilat po i kryejnë, se ka në shumë lokalitete të cilët i ka fillu, por megjithatë takimin e progresit që e kam pas,

përgjigjja e tij ka qenë në adresën timen në këto forme se i kam tregu që këshilltarët kanë ankesa sikur Sejda, më herët ka pas edhe për Zhiti, ne shkojmë me faza. Faza e parë është grymja, e dyta, hedhja e zhavorrit, e treta në këtë formë, megjithatë e ka një operator ekonomik, unë e di që ekziston edhe çështje tjetër. Sivjet jena ballafaqu edhe me mungesë të punëtorëve nuk po du me bë temë, është mungesë shumë e punëtorëve për shkak të largimit për çdo ditë të rinisë tonë në vendet e Europës. Ai nuk e thojke këtë po unë e di që ekziston edhe qekjo, se me pas kapacitetin e para 4-5 vite plotë të rijë këtu ish kry moti, kur fillon rruga "Ali Muhaxheri" nuk e di për nder. Tek çështje e ndriçimit që ngritët, shumë çështje binduni se nivel të Republikës së Kosovës jemi kampionë. Mu është tu më pengu çështja e ndriçimit, ne jemi pikë krejt mi bë çka ka shpija, ndriçim. Edhe njëherë e di që e kam thanë, po pe kujtoj për të mirën se nuk e du venin ma shumë se ju, e as ju më shumë se unë. Komunitatet me të cilat kemi partneritet në Gjermani, a e dini çka më kanë thanë në zyrën time, këtë të cilën ju po vraponi mbas ndriçimit publikë kanë me ju kushtu juve edhe keni me qenë ndoshta personat të cilët do të vie koha që për këtë akt edhe do të dënoheni nga ana e qytetarëve, sepse shumë në kurriz të qytetareve po bëhen shpenzime të mëdha, dhe çka na ka ndodhë neve, si pe shtrojmë rrugën kryesore, vrapojnë qekjo lagje nuk është në Gjermani thotë as rrugët kryesore, po në përjashtim veç rrugët të cilat parashihen rrezikshmëri për qytetarët, ato bëhen po te na që e ka lëshu Zoti për 2 shpi vjen te zyra s'ta nal hiq, un du ndriçim. Duhet ta kuptojmë këtë çështje, derisa te çështja e energjisë nuk bajmë një evolucion, që me na kushtu shpenzimet më të vogla. Besoj që te kontratat që nuk janë tu publiku, vlen qekjo web-faqes që herë punon herë nuk punon, se i pasna këtu edhe Zyrës së Informimit, janë në gjendje me ti thanë, por në rast se kemi ndonjë çështje që me qëllim nuk është bë, e kemi edhe në të mirën tonë edhe të qytetarëve, por edhe në të mirën e përfomances është kjo çështje. Majlindë, në aspekt ligjor nuk kemi të drejtë me ja u dhënë drunjtë skamnorëve, drunjtë duhet me i qitë në ankand publik dhe me i shitë, nuk e kemi kurrfarë të drejte në radhë të parë jo skamnoreve po edhe shkollave ju kishim shpërnda, po aspekti ligjorë. Këtë pyetje e kam bë shumë herë prej kur kam ardh, por nuk kemi të drejtë. Stacionin, kemi pas tentu diçka me bë me një menaxhim, tash jemi në bashkëbisedim me stacionin Gjilan si i vetëm më një udhëheqje nuk mundet me funksionu dhe jemi në bisedime me gjetë modalitetin dhe me të vërtet me ja dhanë funksionin në bazë të investimeve të cilën e kemi bë. Tek çështja trotuarit, Sejdë, vlenë ajo të cilën e thashë, ai ka të drejtë me mat se është pronë e ti, ndërsa nuk mundet me i vendos ato pa leje dhe unë mendoj që ekspert vendosin aty se a janë të dëmshme për komunitetin. Në këtë rast për banoret e Goshices dhe Verbanit, aty janë ekspertë të cilët kanë me vendos, nuk e di në rrjedh nuk jam për projektin, se nuk ka një kërkesë të tillë në komunë, po megjithatë besoj që ekspertët në mesin e tyre një prej njerëzve që janë të interesum edhe ti edhe kryetari i këshillit të fshatit dhe banoret e Goshices kanë me qenë deri në fund që ai me ofru dokumentacion, se nëse nuk ka leje, ai nuk mundet me bë. Faleminderit!

**z.Basri Sylejmani:** Unë kam pyetje për komunën, edhe një pyetje e kam për kolegët e mi të Vetëvendosjes, vetëm Jakupit, jo këta tjerët që mos me hi në polemika. Ne i kemi tre deputet në Parlament të Kosovës, një i LDK-së, e Vetëvendosje, një zëvendësministër, 4. Unë i kisha thanë që, në qoftese ka mundësi këta me pas të ta ndikimi për çështjen e kyqjes në Gerlicë. Ne kemi pas 100 herë, LDK-ja se ka ndreq, PDK-ja jo, ju e keni marr përsipër, hajde ta kqyrmi ku jemi se jo është për të mirën e qytetareve të Vitisë. Unë kisha pas qef që masi i keni deputetet e juv edhe ndoshta i joni mundet me ju ndihmu diçka, edhe ai zëvendësministër, domethënë kisha pas qef Vitia me u lidhe në Gerlicë. E kam një pyetje për drejtorët cili është për djegien e shtëpive Veli Bilallit, ju ka djeg shpija su pagu sa e keni me ligj, unë nuk e di edhe rruga ne Skifteraj 260 metra, Nuhi Zeneli ajo është e parapamë edhe vitin e kaluar sivjet kanë ardh me kanë thanë se ata nuk kanë këshilltar.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Velia është kanë 2-3 here në zyrën time dhe unë e kam thirr drejtoreshën e shëndetësisë që është këtu 2 her e kemi ndihmu nuk kemi fonde të veqnata e njëjta ka ndodhë edhe te rasti që është kanë të Drobeshi të njëjtën metodë i këna ndihmu simbolikisht nuk e di a mrrin vlera 500 mos mu lidhni për fjale, sa është vlera nuk e di, veç ju kemi ndihmu të dyve, por fond të veçantë për diegie të shtëpive nuk kemi. Për rrugën e Skifterajt nuk e di.

**z.Illir Zuka:** Drejtoresh, nuk pata asgjë kundër teje. Një nder ordinancat që ke shkru marrëveshje memorandum me të ka bë memorandum vjet edhe me disa klube. Vetë klubet sa i ka përkrah paraprakisht, domethënë para se me i pas nënshkru ti këtë marrëveshje ka bë memorandum me i ndihmu klubet me 20% zbritje për lëndime, kontrolla. Vetë klubet sa i ka përkrah, i ka shfrytëzu klubet vetëm për marketing, nuk po di me hi më shumë, po në qoftë se do me bë zgjidhje për kërkesën që e patë shefi i grupeve, e ki shumë lehtë. Në aborrin e QKMF-së e ki entin për punësim, është e njëjtës ministri që ministria e financave që i menaxhon te dyat, domethënë me një marrëveshje mundesh me i bartë këto. Kaq, nuk kam diçka më shumë.

**z.Nexhat Halili:** Përshëndetje edhe një herë. Unë i dëgjova përgjigjet e nënkryetarit. Në secilën seancë përgjigjet e njëjta janë, por ku ke puna ndriçimi në Sodovinen e Muhagjerve. Nënkryetar ke në rrugën kryesore jo në rrugët dytësore. Pika tjetër, unë nuk thashë që njoftimet nuk publikohen, njoftimet publikohen por kontrata nuk publikohen në web-faqe të komunës. Te prokurimi kontratat nuk publikohen, merrne kqyrne, njoftimet, po njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie, njoftimi për anulim, por kontrata jo edhe pse këto kontrata janë në prokurimin elektronik. Unë edhe atje i gjaj, por të paktën transparenca të jetë.

**z.Musli Neziri:** Nënkryetar, përgjigjet që i dhavë, në pyetjen time nuk u përgjigje, nuk e di a tu përvjedh, sun e evidentove për rreth punëve që janë bërë në rrugën e Kllokotit. Domethënë, mundësisht edhe aty një përgjigje.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Veç ta kemi të kjart se, procedurat e tenderimit gjithherë dalin në veti, çështja e kanalizimit, çështja e ujësjellësit në veti dhe e ndriçimit në veti, dhe këtu është ajo. Ti e dinë se çështja e ujësjellësit zakonisht merren këta të "Hidromoraves" nuk e kemi të lehtë në këtë drejtim ti e hape veç për këtë zonën po e hapi që kam qenë një ditë me një takim me këshilltarë ndërministrorë. Çështja e ujit do të jetë problematike, nuk jam tip të cilit ju japë informacion, me ju dalë kjo çështje krejt ndryshe do të jetë shumë problematike, aq problematike që fjalori jem është kanë i padëshirum atë ditë në raport me ta, se ata nuk janë këshilltar ndërministrorë të këtij mandati, janë këshilltarë ndërministrorë që 8-9 vite, dhe për Hasan Aliun unë konsideroj edhe për juve është e pakuptimtë që marrëveshja me CDI, se unë ankoem në këtë ankesë dhe me thonj 10 milion, që jam kanë në dijeni edhe unë, është financu nga ana e ministrisë dhe 6 milion e gjysmë nga agjencia zvicërrane të cilët implementuse ka qenë CDI-ja dhe mu me habit fakti se kurr raport nuk ju paska dhanë dhe për mu është e papranueshme kjo çështje, raport 16 milion. Duhet mu ditë, mospajtimi im me këta është për shkak se thonj kemi shti rrjet të kanalizimit. Për mu rrjeti i kanalizimit qaq shkoj larg që nuk është fjalori im, i thamë kjo është sikur në kohën e perandorisë turke, është than se kur janë qu perandoria turke shume ari e kanë lan, myt janë gjinja tu grapu po me gjete nuk kane gjiet hiq dhe mu me intereson qytetari kur të pi ujë e sa gypa ka në toke nuk me intereson mu me intereson kur të ka ujë të bollshëm, e tash me rastin e formimit të bordit të ri, takimi me përfaqësuesin e "Hidromoravës" si menagjer, për shkak se ka ekzistuar një kontratë e cila ka qenë e nënshkrume nga ana e kryetarit, po në anën tjetër e prum në këtë kuvend të cilët ja kanë dhanë fuqishmerinë për 13 fshatra dhe në këtë vit po rrezikomi ne shkurjen e mjeteve suficit, se komuna i ka majt premtimet e veta. Jemi kanë të gatshme me e financu, po asnjëra palë, as DCI-ja e as "Hidromorava" nuk i ka mbajt premtimet të cilat i ka pas në raport me 13 fshatra. Këtë po ta shpjegoj se, problematika e ujit duhet ta keni të kjart, do të keni shumë problem në këtë mandat, e ndoshta edhe në mandatin tjetër kemi mu ballafaqu me këtë.

**z.Musli Neziri:** Tek drejtoresha e arsimit. Faleminderit për përgjigje, por dashta me të pyet, ju i merrni direktivat se ku me pas ndërhyrje nëpër shkolla ose renovime nga drejtorët ose menaxherët e shkollave. Faleminderit për ndërhyrjen që e keni bë në shkollën, në lokalitetin nga vij unë, qe nuk ka pas ujë dhe që është evitu me një rregullim shumë të shpejt nga ai punëtor që nuk e di, nuk e njof, e falënderoj. Ata po kërkojnë nga ti, që drejtorët e secilës shkollë t'i adresojnë problemet që i kanë në renovimin e shkollave, e besoj që kryet për arsye se unë, ti e di qe personalisht kemi kontakti dhe është kry qysh të nesërmen uji, prandaj po kërkojnë që drejtorët e shkollave t'i adresojnë problemet.

**z.Remzi Salihu:** Faleminderit kryesues! A e dini pse dola këtu, se kur njeri shpif ose duhet me dal ballë për ballë ose duhet mu mshef, prandaj unë po përballem me të gjithë. E nderume drejtoresh, në vend që të përgjigjesh konform obligimit, normave dhe etikes, ti fillon në stilin majma nanë fëmijën se... Unë nuk kam shpif asgjë, shumë thjesht thash ka informata, flitet, nuk i kame të konfirmuar, nuk thash decitivisht, prandaj ju lutem ta kesh kujdes fjalorin kur të folsh me mu, sepse nuk je tu fol me një rrugaq, ti je tu fol me një njeri që ka pak a shumë dy ditë shkollë, edhe thu profesor mandej shpifës. Këto dya nuk shkojnë bashkë, që të përmend emra, nuk e di unë që përmenda ndonjë emër, ti aty përmende emrin Arbnor Ademi, nuk e di pse kujt i djeg kjo kush është ai Arbnor Ademi, e di kush është, nuk është problem, po pse menihere me nxjere atë emër në barazpesh me emrat të tjerë, që unë thashë kam dyshime. Domethënë informata të tilla nuk e thash decidivisht, nuk e shpifa asgjë nuk shpifa, por në fund e nderuara drejtoresh, nëse flitet për shpifje, ta rikujtoj shumë thjeshtë edhe mund ta dokumentoj pa problem se, kur të bëhet fjalë për shpije, pikërisht je ti zonja drejtoresh që në një mbledhje gjatë fushatës zgjedhore në fshatin Sllatinë ke shpif, ke thanë Vetëvendosje paguhet nga Rusia.

**Drejtoresha arsimit, Fatbardha Emini:** Ne nuk jemi në fushat politike këtu, as nuk jemi Në tubim, as në elektorat të LDK-Së tu fol, as të Vetëvendosjes, unë me gjithë respektin që kam për të gjithë, secilin anëtarë, sepse jeni të zgjedhurit e popullit dhe në këtë seancë keni legjitimitet pothuaj se më shumë se unë, se unë jam e emrume, i di këto procedura, nuk krahasohet fjala e një tubimi. Ne nuk jemi tu fol këtu në tubim politik dhe askush askund nuk ka shpifë, domethënë janë inskenimet ato që mu kanë njobllo, edhe sot mos e ndërlihd këtë çështje të procedurës ligjore me sene para 30 vjete, ne të ja nisim tash baba jem e baba atij çka ka bë, apo kupton, i nderuar profesorë, e din shumë mirë që me Ligjin mbi Zyrtarët Publik rekrutimin e bënë Zyra e Burimeve Njerëzore, nuk e bënë drejtorja e arsimit fillimisht nuk është dashtë me mu drejtu fare mu kjo pyetje, edhe e dyta, unë të thashë jam e intresume me ditë edhe bashkë me ty ku duhet me denoncu këtë rast. Unë e kam përgjegjësi mua kur të më dërgohet lista këta mësimdhënës me i sistemu nëpër shkolla, unë duhet me ditë a kam kridibilitet, nëse ti ki dëshmi të lutna ma ofro edhe bashkë me ty shkojna aty ku duhet me drejtu, për qata jam tu u drejtu edhe nuk jemi në tubim politik, jemi për kërkesa dhe interesa të qytetarëve, jemi në organ shtetëror tu fol jo në tubim politikë as në kafe i nderuar profesor nuk jam në kafe as në zyre te partisë, jam në institucion që jemi të gjitha subjektet politike, e në zyrat partisë në kafe folëm çka dush e në institucion para mediave, para institucionit këtu që paguhemi me taksa të qytetarëve, ne duhet me dallu këtë me pas kujdes çka flasim nëse un flasë diçka që nuk është e argumentume, unë kam përgjegjësi në subjekt politik nëpër kafe tjetër sen në shtëpinë time ku e dinë ti se çka flasë, nëse mendon që të kam injoru diçka, unë kërkoj falje ndaj teje se nuk e kam bë një gjë të tillë, se për shkak të moshës më vie keq që të debatojë me ty edhe për shkak të titullit profesor, unë jam drejtoresh e sektorit të arsimit dhe kam respekt për secilin profesor, jo vetëm për juve.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje për të gjithë! Basria ma adresojë një pyetje, një kërkesë. Basri ndesh e la që të marrë një informatë taman të saktë, ta sjelli, ndesh ty ose në seancën e radhës çka muj me bë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Vazhdojmë me rend dite. E keni marrë me kohë, e keni pas me material, besoj që materiali herave të tjera do të ju vij përmes laptopëve për shkak se procedurat janë në përfundim para se të hi në rend ditë ju njoftoj që finalja e turnirit tradicional "Gursel e Bajram Sylejmani" është në ora 8 në fushën te Toni, në mes dy Sodovinave. Çdo kush që është i interesum prej kuvendit komunal, unë do të jem aty edhe pjesa tjetër vizita në bazë të kuvendit në Shqipëri të Premten kemi edhe udhëtim edhe vizita, takime çka i kemi i kemi në ditën e parë, që shkojmë që të jemi pak edhe me veshje më soleme, për shkak të pritjeve që keni rend ditën e keni marrë me kohë, nuk po i lexoj, se i kemi 16 pika. Kisha hap debat: a ka dikush për diskutim për rend dite?

**z.Jakup Demiri:** Unë kisha kërku që, nëse ndonjë pikë që pret për kohë me shty për seancën tjetër me reduktu. Ju e keni analizu se perime janë shumë 16 pika edhe nuk e di a mundemi me kry sot.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kemi diskutu shumë, se kemi pa që është shumë ngarkesë po 3-4 pika janë veç me dalë në diskutim publik taksat, ngarkesat dhe gjoba është që e ka kry diskutimin publik, është kanë në kuvend, është veç në miratim. Shumica e pikave janë që janë trajtu, është kodi te bujqësia shumë i nevojshëm, për shkak që me u zanë viti fiskalë që janë shumë të arsyeshme këto pika. Për këtë seancë kemi paraqit këtë:

## **R e n d d i t e**

1. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e rregullt e KK-së.  
b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e rregullt e KK-së  
c) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e datës: 09.08.2022.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2023-2025.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjobë për vitin 2023.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023.
5. a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal e kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Kllokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike.  
b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunat e Kllokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike. c) Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Kllokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale në zonën e kadastrale ne Viti, Radivojc dhe Sllatinë.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e komisionit, për intervistim, vlerësim dhe poentim të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkurset publike për pozitë drejtor, zv drejtor të shkollave filllore-mesme dhe çerdheve të Fëmijëve të Komunës së Vitisë.
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, me Nr. 01-110/05-790 të datës 01.08.2022.
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen “qytetarë nderi” i Komunës së Vitisë, drejtoreshën ekzekutive të MCC-së z. Alice P. Albright.
10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ngritjen e Obeliskut për z. Madeleine Albright
11. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit paraprak me nr. 01-110/05-477 të datës 04.05.2022, për shpalljen me interes të përgjithshëm për hapjen e rrugës së re në zonën kadastrale në Sllatinë.
12. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e kodeve të ri për projektet me perticipim.
13. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft Strategjinë e Zhvillimit Lokal 2022-2026.
14. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në shqyrtim publik Projekt Planin e Zhvillimit Komunal të komunës së Vitisë 2022-2030.
15. Informatë lidhur me raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me datën 31.12.2021.

## **16. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditorit për vitin 2021.**

Me ngritje të dorës kërkojë që të miratohet rendi i ditës. Kush është për, a ka kundër, abstenim? Domethënë më të gjitha votat e pranishme, 24 janë të pranishëm në sallë, miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë të rendit të ditës:

2. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e rregullt e KK-së.
- b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e rregullt e KK-së
- c) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e datës 09.08.2022

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nëse ka dikush me diskutu për procesverbalin që e kemi kthyer për përmasim është diskutu. Kush është për që të miratohet? Pro janë 24, kundër nuk ka, abstenim nuk ka. Pika e parë prapë nën b. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e rregullt e KK-së. Hapi debat për mbledhjen e shtatë. Nëse nuk ka, atëherë kush është për miratimin e tij me ngritje dorës? Pro janë 23, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, një dul jashtë, të gjithë janë pro. Nën c. e kemi Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e datës 09.08.2022. Ka qenë procesverbali më i shkurt. Përgjigjen prej Ministrisë së Arsimit veç e kemi marrë, që naj ka dhanë një informatë. A ka për diskutim? Nëse nuk ka, atëherë e qesim për votim me ngritje dore. Pro janë të gjithë, kundër nuk ka, abstenim nuk ka, me 23 vota miratohet procesverbali I mbledhjes së jashtë zakonshme.

Si pikë e dytë të rendit të ditës:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2023-2025

**Drejtori I financave, Besnik Imeri:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryesues, të nderuar të pranishëm. Si fillim ju falënderoj për pjesëmarrje që e keni bërë në dëgjimet buxhetore, të cilat I kemi pas dhe përmes të cilave kemi arrit në këtë plan buxhet për vitin 2023 për komunën tonë. Plan buxheti siç e dini është përgatit në bazë të statutit të Komunës së Vitisë, duke shpërndarë fondet nëpër kategori programe dhe nën programe në bazë të kufijve buxhetor të caktuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me pranimin e qarkores së parë buxhetore. Kemi mbajt 9 dëgjime publike në të cilat kemi pranuar nevojat, rekomandimet, sugjerimet nga qytetarët si dhe programin e kryetarit për vitin 2023. Të gjithë jemi munduar t'i përshtatim me kufijtë final të cilat I kemi marrë me qarkoren e dytë nga ministria, buxheti në totalë është në shumë prej 14 milion e 996 mijë e 357 euro. Ky buxhet rrjedh siç e dini nga dy burime kryesore, siç është grandin qeveritar, i cili në vete përmban grandin e përgjithshëm, grandin specifik të arsimit, grandin specifik të shëndetësisë si dhe një grandin i cili është dhënë për shërbime rezidenciale, I cili ky burim merr pjesë me 13 milion e 943 mi e 538 euro apo 92.45% të buxhetit të përgjithshëm dhe të hyrat vetanake me 1 milion e 52 e 819 euro, apo 7.55% nga ky buxhet rrjedh kjo strukturë buxhetore e shpërndarë në 5 kategoritë ekonomike, paga dhe shtesa kemi 7 milion e 609 mijë e 386 euro, apo 50.74%, mallra dhe shërbime 2 milion 432 e 766 euro apo 16.22%, shpenzime komunale 325 mi euro apo 2.7%, subvencione dhe transfere kemi një rritje prej 210 mi euro pra janë 570 mi euro apo 3.80% si dhe investimet kapitale të cilat do të jenë më të larta ndonjëherë në Komunën e Vitisë dhe janë prej 4 milion e 59 mi e 205 euro apo 27.07% gjithashtu mundë të gjeni edhe dallimet në mes viteve 2022-2023 ku buxheti I përgjithshëm është më I lartë për 1 milion e 926 mi e 862 euro apo 14.74% apo shprehur në kategori si vijon në paga dhe shtesa kemi zbritje për vitin 2023 për 8918 euro, mallra dhe shërbime kemi rritje për 340 mijë e 62 euro, shpenzime komunale kemi rritje 5 mi euro, subvencione dhe transfere kemi rritje për 210 dhe investimet kapitale të cilat do të kemi rritje prej 1 milion e 380 e 719 euro. Në materialin e kemi paraqitur planifikimin për të gjitha linjat buxhetore, siç janë: administrate komunale, arsimit, shkenca, shëndetësia dhe mirëqenia sociale. Deshta të ndalem te investimet kapitale që sipas linjave bugxhetore më se shumti merr administrate komunale me 87.19% arsimit me 6.16%

shëndetësi 2.71% shërbimet rezidenciale siç e thashë janë 160 mi euro apo 3.94%, ndërsa sipas burimit të financimit 79% merr pjesë grandi I përgjithshëm nga qeveria grandi specifik I arsimit me 1.28%, grandi specifik I shëndetësisë me 2.46% dhe grandi I shërbimeve sociale me 3.94%, ndërsa te hyrat vetanake me 13.15% , kemi një dallim të cilin e kërkon Drejtoria e Shëndetësisë, të cilat në kategorinë e renovimeve në ambullanta kemi kërkesë që të heqim nga I 10 mijë euro të cilat janë, t'i heqim 12 mijë euro dhe t'i destinojmë për pajisjet mjekësore të cilat kanë nevojë urgjente, ndërsa në faqen e fundit mund të gjeni edhe listën e investimeve kapitale për vitin 2023, që janë 33 projekte, nga të cilat 10 janë projekte të përgjithshme dhe 23 projekte specifike. Këto 10 projekte të përgjithshme janë projekte në vijim, të cilat janë disa vjeçare me kontrata të nënshkruara, të cilat na obligojnë edhe për vitet e ardhshme që të kemi një kodë për to.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit drejtorë për prezantimin e buxhetit para anëtarëve të kuvendit. Materialin e keni marrë me kohë dhe ky buxhet lidhet me qarkoren buxhetore që e kemi diskutu një here. Pjesa më e madhe tash çka mund të diskutohet është pjesa e të hyrave kapitale që nuk janë kanë të specifikume në pjesën e parë që e kemi diskutu, që dallon prej buxheteve të tjera që i kemi pas përherë në diskutim. Në këto debate kësaj radhe për herë të parë është një listë që ka shumë projekte, sepse zakonisht kanë qenë të përgjithshme. Kësaj radhe ka më shumë të specifikume diku 30 që shkojnë. Kjo është një risi në buxhet.

**z.Ali Bajrami:** Unë nuk do të ju lodhi me shifra shumë, se i potencoj dhe I ceki drejtori që e falënderojë për këtë spjegim dhe sqarim. Ajo që vlen të ceket dhe të theksohet në këtë KAB, e duke e nda me pasqyrat dhe të paraparat që janë për vitin 2023, që kemi një rritje që është për çdo lavdatë, kur I marrim I krahasojmë projeksionet buxhetore të viteve të mëparshme me vitin 2023 aty ku isha përqendru më shumë nëse e bëjmë veç një krahasim të thjeshtë të kufijve buxhetor 2023-2022, kemi te grandi I përgjithshëm, rritje për I milion e 548 mijë e 194 euro, grandi I shëndetësisë për 233 mijë e 320 euro dhe te hyrat vetanake 64 mijë e 951 euro. Kur të bëhet rikapitulimi I krejt kësaj rritje në projeksionin buxhetor për vitin 2023 kemi për I milion e 926 mijë e 862 euro. Me këtë rritje kisha veq rritjen që e kemi te investimet kapitale, te ajo pjesa paga mëditje, shërbime, mallra. Me një mënyrë ato janë të përcaktume dhe nuk kisha hi me laburu. Ajo që vlen të theksohet, se në buxhetin e vitit 2023, investime për shpenzime kapitale bënë pjesë me 27% që mos me destinu 07, që kur marrim dhe analizojmë krejt buxhetet e mëparshme, investimet kapitale kanë qenë nën 20%. Kjo rritje na mundëson që të bëjmë investime dhe ti prekim të gjitha lokalitetet dhe qytetin e Vitisë aty ku ka nevojë te pasqyrat edhe te kodimet që e përmendi edhe kryesuesi. Mirë është që është bë që janë specifiku, gjithsej I kemi 33 kode të specifikume, të kodume ku kanë me u bë investime edhe në këto 33 investime janë të përcaktume edhe është vlera 4 milion e 59 mijë e 705 euro. Çka mbete tjetër që të bëhet një përkushtim dhe një angazhim, pasi jemi tu fol për buxhetin e 2023-ës, që të bëjmë përpjekje për rritjen e angazhimit që të rrisim inkasimin e të hyrave vetanake, që me një mënyrë përpos këtyre që I kemi të parapamë, të specifikume me grumbullimin, rritjen e inkasimit, të bëjmë edhe investime aty ku na paraqitet nevoja.

**znj.Liridona Bislimi:** Në emër të grupit parlamentarë të Vetëvendosjes do ta mbaj fjalimin unë, kështu që shpresoj që nuk do të kemi probleme me kohen. Të nderuar të pranishëm, ne pranë vetes kemi sot dokumentin më të rëndësishëm te këtij legjislacioni politik, pra planifikimin buxhetor, ku përmes buxhetit ne kuptojmë që është instrumenti më i rëndësishëm i politikës që ka në disponim qeverisja lokale dhe si i tillë ai pasqyron prioritetet e tij përmes tij ne rregullojmë të hyrat dhe shpenzimet për një vit fiskal të caktuar dhe përmes buxhetit ne përbejmë të hyrat e qytetareve nga tatimet dhe taksat investimet të cilat duhet te orientohen në bazë të prioriteteve dhe kërkesave të qytetareve. Ajo çka jemi mësuar të dëgjojmë vazhdimisht nga kryetari ynë i komunës, është ankesat e vazhdueshme se qeveria nuk ka ofruar mbështetje të nevojshme për qeverisje lokale e kësaj here na patjetër duhet ta theksojmë se rritja e këtij buxheti në përgjithësi është prej 1.9 milion euro, prej te cilave ai për projekte kapitale është rreth 1.4 milion euro, pra kjo dëshmon të kundërtën të nderuar të pranishëm. Ky projekt buxhet për vitin 2023-2025 ashtu si edhe planifikimet buxhetore te kaluara me shqetësim të madh na bënë të kuptojmë që ky planifikim në destinim të mjeteve për qytetarët tanë është fokusuar në projekte infrastrukturore të rrugëve me zhavorr e që vërtet arrin një vlerë tejet të madhe, mandej kemi shpenzime shumë të mëdha në ndriçimin publik dhe në asfaltim të rrugëve rurale

ku në anën tjetër fatkeqësisht nuk ju kushtohet rëndësi projekteve jetike dhe të domosdoshme si është ai i ujit të pijes e që ky buxhet për ujin e pijes ka nda një shumë prej 40 mijë euro për filtra në fabrikën e fshatit Letnicë, e që për këtë gjë do të duhet patjetër ta kujtojmë që për vitin 2022 kanë qenë të planifikuara 221 mijë euro për 2023 kanë qenë të planifikuara 248 mi euro e tani janë ndarë vetëm 40 mijë euro dhe për 2024 kanë qenë të planifikuara 202 mijë euro, tani janë vetëm 130 mijë euro. Si shpjegohet nga ana e juaj drejtorë ky ndryshim nëpër shifra për një çështje kaq të ndjeshme për qytetarët tanë? Si Lëvizje Vetëvendosje, ashtu edhe si në vitet e kaluara ku kemi ofruar prioritetet tona në këtë kuvend si opozitë e parë, ne do të veprojmë njësoj edhe kësaj here, pasi që besojmë që këto prioritete të cilat janë lënë anash janë në interes të madh për qytetarët tanë, prioritet i grupit të asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje për buxhetimin komunalë të Vitisë janë. E para, investimi më i madh në fabrikën e ujit në fshatin Letnicë për rritjen e kapacitetit të ujit, keni paguar pagat jubilarë të shëndetësisë, por nuk i keni bërë pagesat në sektorin e arsimit 120 euro për grat lehona, fond për persona me aftësi të kufizuar, rregullimi i kanalizimit, trotuareve Viti-Kllokot, zonë e zhvilluar me biznese rritjen më të madhe të bursave për studentë. Një investim kapital në bujqësi, kërkesë e qytetareve për një treg të gjelbër në aksin rrugorë Radivojc, Skifteraj, Gjilan, vendosja e mamografisë në QKMF-në e Vitisë, subvencione më të mëdha për biznese dhe në fund ne nuk kemi njohuri se sa buxhet do të ndani për viktimat e dhunës në familje, që është në plan program në riintegrimin e tyre. Si përfundim, përmes këtij projekt buxheti pasqyrohet më së miri edhe koncepti qeverisës i qeverisjes Haliti në Viti për vitin 2023 dhe parashikuese, pasuese për vitet 2024-2025, pra si qeverisje lokale në Viti në krye me kryetarin e saj, Sokol Haliti. Fjalët e këtij buxheti janë asfalt, zhavorr dhe ndriçim publik.

**z.Taulant Haxhiu:** Përshëndetje! Unë po e shofë që projekt buxheti i Komunës së Vitisë 2023-2025 është 14 milion e 996 mijë. Kemi diku një rritje 1 milion e 926 mijë euro. Unë e kam një propozim, që me 1 rritë subvencionet në bujqësi, kulturë dhe segmente tjera, duke i zvoglu investimet kapitale në asfalt dhe zhavorr. Vitia ka bërë edhe do rrugë të panevojshme që nuk janë të nevojshme hiq. Gjatë vitit 2023 e pashë që mbi 4 milion euro kemi projeksione të investimeve kapitale të kemi konsideratë me investu të paktën 500 mijë euro në rrjetet e ujësjellësit. Siç e dimë pritët edhe fshati Stubell me u lidhë prej fabrikës Letnices, sipas informatave që I kamë 1/4 e ujit e merr fshatit Stubell dhe Vitia me rrethin mundet me mbet edhe pa ujë. Te shpenzimet, unë e kamë një propozim të ulen shpenzimet për mallrat dhe shërbime dhe të rritet buxheti i inspektorave me bërë inspektime sa më shumë. Në qoftë se kemi inspektime sa më shumë, atëherë do të kemi edhe inkasime sa më shumë.

**z.Musli Neziri:** Drejtori elaboroj që këtu një grand për herë të parë që tha shërbime rezidenciale 160 mijë euro në kuadër të kësaj këtu e përshkruan për shtëpitë e komunitetit me persona me aftësi të kufizuara, për shtëpitë. Tash ta kemi të qartë këtu, shkrun për shtëpitë e komunitetit, prandaj ta dimë a është për një vend ku do ta kenë ata të trajtohen apo për shtëpitë e tyre me I trajtu, shtëpitë me ja u rregullu, shtëpitë po du me than pse është e shkruar kështu. Te pjesa tjetër te arsimit, meqenëse është grand specifik, drejtoresha nuk qenka këtu, po dashtë një diçka që mu ndërlihd shumë, se besoj që është e dhimbshme, besojë për të gjithë dallimi në mes vitit 2021-2022 me vitin shkollor kemi qenë dikund në bazë raportit të DKA-së që na u kanë raportu 264 nxënës, kemi qenë në minus. Sa për informatë, krahasimi me vitin 2022 me 2023 tasht na del që 606 nxënës jemi më pak, prandaj edhe zbritja te arsimit atje ku po shihet që në bazë të numrit të nxënësve që ndahen mjetet ka edhe zbritje për 2023, e që për 2024 parashikimet janë që me pas një rritje, mirëpo kjo është si shqetësuese sa e pash, që më shqetësoj kjo pjesa e numrit ramjes kaq shumë, një komunë kaq e vogël që jemi ne pjesa tjetër e buxhetit. Kanë qenë në diskutim ato, domethënë aq sa është. Parafolësit I ngritën disa çështje. Mendojë vetëm trajtohet aty ku ka nevojë, besojë që është e arsyeshme.

**z.Illir Zuka:** Dua të ja filloj këtij projekt buxheti me lavdata kur kemi mbi 14 milion euro investime për herë të parë në historinë e Komunës së Vitisë. E di që se në vitin 2015, 1.6, tashti ka shku 14 milion, është shumë punë e mirë. Çka deshta me diskutu, lavdatë të mëdha për rritjen e subvencioneve, domethënë në bujqësi, kulturë, rini dhe sport, që e kemi pas edhe dëgjimin buxhetor, që kanë pas kërkesa edhe që ka rritje, sidomos kultura, rini, sport ka 100%. Kish shumë projekte që janë, që kanë me shku investimet. E kamë një frikë te këto projekte, ato që po janë me bashkëfinancim, sidomos në nivelin qendror që I kemi, janë 6-7

projekte të mëdha në Komunën e Vitisë, bashkëfinancim me ta edhe nuk merren hiq me atë punë tu e fillu palestra, stadiumi "Vllaznisë" Pozheran, e shumë të tjera. Uroj që mos të na ndodhin këto, unë tash masi po vijë prej Pozheranit, dëgjimin buxhetor që e kemi mbajt në Pozheran, I kemi pas disa kërkesa. Na kemi llogaritë kur e kemi prish shkollën "Halil Alidema", shkollën e vjetër, e kemi mëndu njëherë aneksin me lanë me e renovu, me bë si shtëpi të kulturës për funksionim të zyrave, e shumë sendeve të tjera, por me një vendim e kemi vendos për me hjek. Tash kemi pas mëndu që do ta parasheh Komuna e Vitisë një shtëpi të kulturës ne Pozheran, kur dihet se para viteve të 70-ta e ka pas. Ata e dinë edhe nënkryetari shumë mirë, kemi pas kërkesë të 3 lagjeve për trotuare se secila lagje, lagjja "Zuka", lagjja "Alidema" edhe pjesa e "Muhaxhereve" janë mbi 200 shpi secila lagje aty gravitojnë shumë fëmijë që shkojnë nëpër shkollë, siguria është 0, tu e llogritë që asfalti është 3.5 metra, vende vende, por në shumicën 4 metra. Uroj që nënkryetar të I merrni këto kërkesa pak me seriozitet. Edhe një kërkesë e kam për plus televizionin. E di që e ka nënshkru marrëveshjen, mundësisht seancat tjera me I bë 2 kamera, se po na ingjizon prej mbrapa, veç kryet po na e qitni.

**znj.Zyrafete Rama:** Përshëndetje të gjithë të pranishmit! Meqë jemi te rendi i ditës, te pika projekt buxheti, fillimisht më lejoni të ju uroj të gjithë qytetarët për buxhetin e vitit 2023, ku shpresoj dhe uroj që ky projekt buxhet t'i adreson kërkesat dhe problemet e tyre. Si përfaqësuese e qytetarëve dhe banore e Pozheranit, edhe unë po ashtu si Iliri, në bazë të kërkesave që janë adresu tek unë, edhe njëna prej tyre që e kemi diskutu më gjatë edhe në këshillin e prindërve, ka qenë kërkesa që në buxhetin 2023 të ndërtohen 2 nënkalime për rreziqet që janë në rrugën kryesore. Domethënë 2 nënkalime ose edhe rrethrotullime, varsisht se si e shohin ekspertët e komunikacionit, edhe mundësitë buxhetore të komunës. Besoj që kjo ka me lehtësu punën jo vetëm të nxënëseve, por edhe të moshuarve për kalimin e rrugës. Meqenëse është rrugë kryesore dhe e dimë që është rrugë shumë e frekuentume besoj që këtë kërkesë do ta merr në mbështetje institucioni, duke e ditur rëndësinë dhe vështirësitë që i kanë pozheranasit.

**z.Nexhat Halili:** Edhe unë njëjtë si koleget e tjerë, pe përgëzojë drejtorin e financave për këtë buxhet i cili ka rritje prej 14.74%. Në faqen numër 10, drejtorë te kufijtë paga dhe në staf për vitin 2022 dhe 2023. Për vitin 2022 kanë qenë 1161 punëtorë. Në seancën e kaluar kur kishim në shqyrtim kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2023-2025, numri I punëtorëve për vitin 2022 ishte 1161, ndërsa kishte rritje te Drejtoria e Shëndetësisë dhe aty për 6 mjekë në bazë të qarkores buxhetore. Në bazë të llogarisë time, nuk është 1165 në 2023, po është 1167. Pse ka ardh deri këtu, po kërkojë një përgjigje, edhe pse tash po shihet që ka zbritje. Në fillim të buxhetit për 8919, kur llogariten për dy punëtorë, dalin pagat e këtyre dy punëtorëve. Tasht po dalë te të hyrat e buxhetit. Këta dy punëtorë në 6 që rriten në Drejtorin e Shëndetësisë, dy I ki mungesë në Drejtorin e Arsimit. Arsyen pse ti duhesh me na e dhanë arsyen, pse unë tashti po hy te të hyrat vetanake. Për mu të hyrat vetanake, përgëzoj që ka rritje, por nëse inkasohen, mirëpo unë kam vërejtje nëpër pika. Te parkimi publik, ju keni parapa për 2022 6535 euro, ndërsa për 2023, 600. Parkim publik sa di unë nuk keni inkasu 0 euro. Te lejet e ndërtimit keni rënie prej 2022 në 2023, prej 49473 euro keni në 25 mijë euro. Te pika tjetër, të hyrat nga qiraja, keni parapa 8640 euro për vitin 2022. Nuk e di sa keni inkasu, mirëpo për 2023 I keni potencu se është 0 euro, kur ne në këtë kuvendin tonë kemi votu për barnatoren për shtëpinë e shëndetit. Nëse ajo jepet me qera, për këtë vit të paktën 2 muaj inkasohen nuk keni parapa qera. I kemi edhe pozicioni të tjera që ka zbritje, edhe te Drejtoria e Inpekcionit, drejtor, ki zbritje të buxhetit. Tashmë të projektet investive, edhe me këtë buxhet te projektet investive, sidomos asfaltimi I rrugëve rurale, rregullimi I rrugëve me zhavorr, ndërtimi I trotuareve dhe ndriçimeve publike, edhe në këtë keni shku me avazin e vjetër sikur vitet e kalume. Nuk keni bë kurrfarë specifike se cilat rrugë parashihen të asfaltohen, të rregullohen me zhavor ose me asfalt, ose me trotuar ose ndriçim publik. Pika tjetër, te asfaltimi I rrugës Viti Sllatinë e Ulët, në vitin 2021, me datën 26.10.2021 është lidhë kontrata në vlerë prej 224 mijë e 667 euro e 20 cent. Kjo kontratë ka qenë dyvjeçare, mirëpo kjo kontratë deri me datën 27.07.2022 nuk ka fillu fare në implementim. Tash me datën 27.07 është një vendim I cili nxirret prej kuvendit dhe anulohet kjo kontratë. Kjo kontratë është anulë me arsyetimin se nuk ka fillu implementimi, ka pas mungesë në projekte dhe ndryshimi i çmimeve për ndryshim të çmimeve. Edhe unë po them se ka pas ndryshim të çmimeve, mirëpo

për këto dy pika nuk mundem me arsyetu. Kontrata e re është lidh me 20.09.2022, 544 mijë e 251.89 euro. Merre llogaritne një diferencë mes 544 mijë e 251 me 224 mijë e 667, sa ke është një diferencë shumë e madhe. Nuk besoj që inflacioni aq tepër e ka kapë për me shku me këtë çmim edhe çka është problem më i madh, është lidhë kjo kontratë me të njëjtin operator që ju ka ndërpre kontrata. Është refuzu i pari kanë shku me të dytin.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Merre një shkresë dërgoja Agjencionit Antikorrupsion, dërgoja gjykatës.

**z.Nexhat Halili:** Ka një dallim në mes planifikimit, i cili ka qenë 390 mijë me lidhjen e kontratës. Kesh tu e lidhë tjetrën, tash për shembull, se kjo kontratë ka validitet deri 2024, a asfaltimi i rrugëve, pika 28, te projekte investive, ka vetëm buxhet të ndarë për 2023, nuk ka edhe për 2024. Njëjtin rast e kemi edhe te asfaltimi i rrugëve, edhe aty ka një devijim shumë të madh mes planifikimit edhe lidhjes së kontratës. Unë po ndërlihdna zotëri kryetar, se edhe buxhetin e Gjermanisë me këtë gjera nuk e plotësoni.

**znj.Majlinda Shabani:** Faleminderit shumë kryesues. Fillimisht të qenit asambliste e re në kuvend e ka edhe një aspekt tjetër pozitiv, gjë e cila të lejon me i pa punët edhe pikat në diskutim me një perspektivë tjetër, me një perspektivë të qytetares së Komunës së Vitisë, e cila kërkon llogaridhënie nga kryetari i komunës për mënyrën e qeverisjes së tij, për mandatin e 3-të me radhë dhe plotësimin e nevojave të qytetarëve. Jo rastësisht e përmenda mandatin e 3-të me radhë, për shkak që e dimë që po himë në një dekadë qeverisje, andaj edhe buxheti i Komunës së Vitisë konsideroj dhe insistoj që të trajtohet si instrumenti më i rëndësishëm ekonomik i politikës ekonomike, që si e tillë e dimë që i pasqyron projektet edhe investimet që si komunë i kemi, e cila në fund natyrisht që ka mu legjitimu me votën e gjithsecilit prej ndesh. Andaj fillimisht është mirë më ditë se çka po dëshirojmë dhe çka kemi momentalisht si qytetar të Komunës së Vitisë. E dimë që prioritetet vendosen në bazë të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve. I dimë edhe dëgjimet publike që i kemi mbajt, mirëpo këto kërkesa të themë të drejtën për 9 vite qeverisje kanë qenë përpos mosrealizime, premtime të njëpasnjëshme. Më lejoni të jem pak më e qartë karshi investimeve kapitale dhe karshi mënyrës së qeverisjes së kryetarit Haliti. Paraprakisht, para se me fillu komentimin e projekt buxhetit të Komunës së Vitisë për vitin 2023-2025, dokument që shumica e qytetarëve të Komunës së Vitisë ndoshta nuk kanë shfaqë interesim për me e pa, për të vetmen arsye më të thjeshtë për shkak të dëshpërimit nga mosrealizimi i kërkesave dhe nevojat e tyre bazike, sidomos edhe investimeve që janë bërë në komunën tonë, që nëse e shohim mënyrën e investimeve, jetëgjatësinë e saj, kualitetin që është bërë, e krejt në fund se sa është shfrytzu nga qytetarët e Komunës së Vitisë, mundem me thanë që i vit ose 2 vite qëndrueshmëri, edhe në fund po fillojmë prej 0. Domethënë këto taksat e qytetarëve shkojnë në lloq. Të nderuar koleg, fillimisht orientimi i buxhetit të komunës ku e kemi para nesh, në faqen 28, ku janë të theksuar projektet investive publike për vitin 2023, mundemi me konsideru si pasqyrim të asaj që komuna ka prioritet, mirëpo të them të drejtën, tu i bazu ato në kohë fushate, me premtimet që kryetari i komunës i ka bërë, mu po më rezultojnë në mospërputhje të asaj. Çka po e shohim konkretisht, nuk po e di analizën të cilën e kanë bërë edhe sa janë mundu me i shfrytzu kapacitete që komuna i ka realisht për përmbushjen e kërkesave dhe nevojave bazike. Po më intereson me ditë se, ku është rregullimi i ujësjellësit, meqenëse nënkryetari nuk është këtu, kryetar, nuk kemi ujë të pijshëm për banorët e fshatit Lubishtë, mirëpo edhe shumë banorëve të tjerë i është premtu zgjidhja e këtij problemi. Realisht kam prit që ujësjellësi me qenë e para në listë për shkak të rëndësisë së veçantë që e ka, mirëpo të listum kemi asfaltim, kështu që për mua kjo është e papranueshme. Po mendoj edhe shumicën prej juve. Kjo është e papranueshme, kërkesë, prioritet nevojë bazike është uji i pijshëm. Kryetar, pika tjetër është te asfaltimi i rrugëve ku janë të riradhitura e të specifikuarat rrugët, po e shofë asfaltimin e rrugës se Gjepes, Lubishtë, asfaltim ky i premtum shumë vite më parë në mandatin e dytë të qeverisjes, mirëpo prapë se prapë më mirë vonë se kurrë, mirëpo banorëve të fshatit Lubishtë po ju intereson me ditë edhe rruga e cila ka fillu punimet e sajë qysh në kohe fushatës tashti i vite edhe nuk është përfundu hala, po flas për rrugën Lubishtë-Letnicë, e cila është vazhdim i rrugës “Luftëtarët e Lirisë”. Gjithashtu e kemi edhe rrugën “Elmaz Rrahimi” në Buzovikë, e cila nëse nuk gabojë ka qenë dikun në 2011-2012 si projekt ndoshta edhe i perfundum me dokumente, mirëpo realisht nuk ka fillu asnjëherë. Pika tjetër po e shofë që janë nda 300 mijë euro për ndërtim të trotuareve dhe ndriçim publik, edhe pse nuk janë specifiku

lokacionet, një shumë begi e konsiderueshme, bile bile shumë ma e konsiderueshme se sa prioritetet që I kemi si komunë, andaj po shpresojë që këto mjete realisht mu destinu në ndërtim të trotuareve, ndërtimet me u bë ne atë mënyrë që me u shfrytzu prej qytetareve tanë. Edhe ndriçimi me ju mundësi secilit lokalitet tu e përfshi këtu edhe fshatin Lubishtë, e cila është gjysmë me ndriçim dhe gjysmë pa ndriçim. Gjithashtu edhe fshatin Buzovikë dhe shumë fshatra të tjerë. Pika tjetër ka të bëjë tek emërtimi riparimi nëpër shkolla ku është 250 mijë euro që fillimisht e konsiderojë vlerë të pamjaftueshme për sa I përket riparimeve nëpër shkolla. Kam pas takime, kërkesë emergjente prej drejtoreshës së arsimit. Pra sa I përket shkollës së fshatit Lubishtë, ku kam kërku që në mënyrë emergjente me u bë rregullimi I qatisë, kulmit të shkollës, për shkak se është e pamundur që fëmijët me zhvillu mësimin në ato klasë ku ka myk, kështu që po rrezikojmë shëndetin e fëmijëve tanë po e rrezikojmë jetën e fëmijëve tanë, kështu që kam kërku që me u nda një kodë I posaçëm buxhetor që me u ba rregullimi I sajë, mirëpo në projekt nuk jam tu e pa që është tu figuru ajo. Për fund kisha dashtë në diskutim me pas edhe fushën e bujqësisë, për shkak që është ndoshta edhe fusha të cilën e studioj edhe mënyrën të cilën e shofë po du pak a shumë me I specifiku. Po e shofë që kemi rritje të buxhetit, mirëpo ajo çka me intereson është me ditë se, ku ka me u orientu ky buxhet dhe se sa ka me qenë në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e fermerëve, andaj kërkesë e para e imja dhe prioritet, sidomos prej Drejtorisë së Bujqësisë është që me shtu kapacitetet e punës së saj edhe me pas investime kapitale në bujqësi. E dimë që nëse dojmë me pas zhvillim ekonomikë në komunën tonë, e kemi mundësin përmes potencialit që Komuna e Vitisë e ka në bujqësi, andaj unë I kisha dhanë disa propozime të mia. Nuk e di se sa kishin mujt me u marrë parasysh prej drejtorit, ka të bëjë prioritet me analizat e tokës, kisha porpozu që me u bë analizat e tokës për të githë fermerët e Komunës së Vitisë, sidomos për ata fermer të cilët kultivojnë bimë shumëvjeçare, si për shembull arra, molla, lajthia, dardha e te tjera. Gjithashtu duhet një vëmendje edhe prioritet I rritjes së sipërfaqeve të bimëve manore, sidomos të bimëve aromatike mjekuese, për shkak se e dimë që janë shumë në trendë, edhe mendoj që si komunë kishim mujt me arritë me qenë shumë konkurruese në treg. Gjithashtu edhe furnizimi I fermerëve me makineri bujqësore. E dimë që ndoshta kjo është një problem, mirëpo përmes donatorëve dhe përmes participimit që si komunë kishim mujt me realizu, mendoj që kishim mujt me bë një punë të mirë për sa I përket plotësimit të nevojave që fermerët tanë I kanë gjithashtu edhe një sistem unik për mbrojtjen e bimëve dhe kulturave bujqësore nga fatkeqësitë natyrore dhe gjithashtu me pas edhe parasysh rregullimin e rrugëve të arave. Gjithashtu për fund po du me cekë ndarjen e subvencioneve që bëhen nga ana e komunës sonë. E dimë që kemi një rregullore e cila është miratu në vitin 2016, më ka interesu me pa atë rregullore, po e dimë që me dokumentacione si komunë figurojmë shumë mirë, mirëpo se sa po I zbatojmë ato, mandej është tjetër gjë. Kam pas ankesa të mjaftueshme për ndarjen e subvencioneve që janë nda në komunën tonë, sidomos për listën e përfituesve të multikultivateve dhe serrave, kështu që mendoj që duhet me pas një lloj transparence për sa I përket mënyrës se si po punojmë si komunë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Në rast se vazhdojmë në këtë formë me na spjegu në politikë, infrastrukturë, në bujqësi, ne i bëjmë këtu 3 javë. Qëllimi jonë është paraqitja e propozim buxhetit. Qëllimi i këshilltarëve duhet të jetë ku propozon me ndryshu qëtu dhe nuk duhet me fol as për vitin 2022, as për vitin 2011, se 2011 këshilltarët këtu nuk e mbajnë edhe në mend çka ka qenë. Unë po e thanë si sugjerim se, në rast se vazhdojmë në këtë formë, i kemi 16 pika të rendit të ditës dhe duhet ta ruajmë në radhë të parë freskinë si këshilltarëve edhe si qeveri komunale për pyetjet dhe përgjigjet dhe për daljen dhe aprovimit e një buxheti sa më të mirë për qytetarët e Komunës së Vitisë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nuk e nderprejta, se është pikë e rëndësishme dhe me fillim te çështja e buxhetit, nuk e aplikova çështjen e kohës hiq, sepse është pika më e rëndësishme dhe tani po diskutojmë I vit për çështjen e buxhetit për implementimin e buxhetit për të gjitha ato që janë dhe në kuadër të kësaj unë po e shofë që një pjesë e këshilltarëve nuk po munden ta kalojnë katunin e vet. Një duhet me ditë, asnjëri nuk është përfaqësuesi i fshatit, këtë duhet ta dini obligimin për çdo fshat e kemi të njëjtë, sepse përfaqësues jemi të kuvendit komunal. Ligji mi Zgjedhjet Lokale, jemi domethënë përfaqësues të gjitha fshatrat, këtë duhet ta dijë gjithsecili, duhet me kalu ata dhe çështja e buxhetit kësaj radhe shifet që ujë të pijshëm ka 4 fshatra që ka me u investu, kur ta lexojmë buxhetin së paku ta lexojmë mirë. Është fshati Ramjan, Novosellë,

Devajë dhe Radivojcë. Që janë rrjet është shtimi i kapacitetit të ujit që ka qenë kërkesë ekskluzive edhe e jona edhe me partneritet që kemi bisedu. Mua më kish interesu që janë palestra sportive në dy shkolla, që për herë të parë është çerdhja në Drobesh. Domethënë që janë disa pika shumë të rëndësishme që kësaj radhe kemi diskutu shumë dhe i kemi shti në buxhet që ka qenë edhe premtim i fushatës, mirëpo ne jemi tu e bë buxhetin, nuk do të flasim për premtime, se parimisht premtimet ne i kemi fol krejt, se krejt kemi fol për çerdhe, për ujë, për të tjera, se ato janë nevoja të qytetarëve. Mirëpo po më intereson a ka pas ndonjë kërkesë në debat publik, se në debate publike në shumicën unë kam marrë pjesë edhe me nënkryetarin edhe me drejtorin e financave ose naj kërkesë që na ka ardh prej këshilltarëve komunal, për diçka në projektësim, që nuk ka hi këtu në projekt ose është kanë ndonjë kërkesë gjatë debatit ose ka ardhë me shkrim ose që ka ardhë në zyre. Drejtor, a ka pas ndoshta të diskutohet diçka.

**z.Nexhat Halili:** E potencoj nënkryetari, mos i merrni dallimin mes 2023-2022, mirëpo ky buxhet bëhet krahasimi i 2022 me 2023, e për këtë arsye unë e përgëzoja drejtorin që ka rritje të buxhetit sidomos të hyrat vetanake, mirëpo krahasimi bëhet në mes 2023-2022. Tash asfaltimi i rrugëve, nuk po e di se të cilat rrugë, cila rrugë është në Tërstenik që asfaltohet ose shtrohet me zhavorr.

**z.Illir Zuka:** Disi mu dokë kryesuesi tha: secili po i mbron fshatrat e veta. Unë kam pritë që për Pozheran te ditë për lokalitet sa është i madh mos me fol unë hiq, tu i ditë premtimet e juve në fushat. Në dëgjimet buxhetore që i kemi mbajt, unë e di sa kërkesa i kanë bë qytetarët e Pozheranit, edhe e di se sa munden me u realizu. Ne i cekem ato çka janë më primare, se unë e di që edhe administratori i Qifllakit ka ardh me 25 kërkesa, 22 banorë i ka krejt, po unë deshta me marrë kërkesat çka janë elementare për jetesën, se nuk e lidha që jam vetëm i Pozheranit.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje për të gjithë! Faleminderit kryesues! Deshta pak me u lidhë me nënkryetarin, se nuk po më pëlqen edhe kjo qasja e juaj që realisht ne po flasim për një projekt buxhet 1 vjeçar të komunës dhe nuk keni durim të dëgjoni krejt këta anëtarë të Lëvizjes Vetëvendosje çka diskutojnë nuk e kap kohen më shumë se 15 deri 20 minuta. Nuk pashë diskutim nga palët e tjera, ka pak specifikë, por të kujtojmë se kjo është parja e qytetarëve dhe ne duhet ndoshta edhe 1 javë nëse ka nevojë me nejt dhe me diskutu se jemi duke e hargju paren e qytetarëve. Nuk dashta me marrë fjalën në emër të grupi parlamentar, për shkak të shëndetit që e kam këto ditë, por vetëm po ja rikujtojë gjithsecilit qëtu që, në kohë fushate keni shtru asfalte nëpër aborre, keni bë ndriçime publike për votë me pare të qytetarëve, për shkak se nuk i keni potencu me kohë në projekt buxhet ato investime kapitale, me i emru se ku kanë me shku, e mandej po keqpërdoret parja dhe ti e dinë se për në Smirë po flasë nuk po flasë për vende të tjera, por për në Smirë e dijë se si i keni bë marrëveshjet për vota dhe keni shtu asfalt në oborr. Edhe kjo mua më dhembë dhe unë jam përfaqësuesi i popullit më ka votu populli me ja mbrojt këtë pare edhe këtë pare normal që duhet me mbrojte kështu kur të bëhet bugjeti me folë për këto gjera dhe për të gjitha edhe ju kisha lutë që mos ti majm dert kërkujtë më falë se kemi edhe lidhje familjare nënkryetarë është pakë e randë secili ne ta thotë atë sa e dinë e ka votu populli e ka pru nuk ka nevojë me msu e ka vlersu tjetër kushë vota e ka vlersu ta lëmë ne të punon se asgjë nuk ka të keqe prej këtyre e keqja është në qeverisje kur të keqpërdoret parja e qytetareve në qeverisje shtrohen asfaltet neper oborre për vota është shtru në Smirë ti thojmë senet haptasë për këtë ka nevojë për më gjatë me diskutu kjo mirë është me u diskutu paraprakishtë pa ardhë hala qëtu me diskutu me neve e këtu tani janë formalitete por ne nuk dimë kurgja hiq debatet publike mbahen sapër sy e faqe ne si Smirë prej 2015 kemi pru rregullishtë rekomandime më nuk ka vullnet unë kam diskutu me drejtorin e financave një ditë edhe më luti se nuk po i binë , ne i kemi 5 prioritete të fshatitë të dorzume prej 2015-2016 që ke qenë edhe ti pjesë e këshillit të fshatit asnjë her nuk janë kry këto projekte me prioritet të banoreve edhe të këshillit të fshatit por janë bë me marrveshje të ndryshme për sene të ndryshme e pashë që ka emrime më shum të rrugëve urojë që kjo të përparon edhe të ardhmen por nuk është veq zgjedhorë edhe kjo e ka se e dimë ne se qka ka ndodhë këtu ,dorën në zemer nuk është dëshirë e imja të behet ky muhabet se ne jemi njerëz por e kam obligimë me mbrojtë të drejtën dhe me thanë të drejtën dhe atë qka ka ndodhë për këtë jamë i betuarë edhe këta ka me vazhdu për deri sa mundem ose lë krejt.

**z.Basri Syljemani:** Po e kursejmë pra kolegun që është pa qef, po kjo që po thotë ka shtru rrugë nëpër oborre, kjo është për prokurori, është vepër penale automatikisht është dashtë ti me dergu në prokurori në qoftese ka shtru asfalt në oborr ose duhet me u përgjigj ju zotëri kryesues i grupit parlamentar, unë nuk e di me u shtru asflati në oborr edhe mos me marr përgjegjësi, mu nuk ki çka me më dhanë, shko lajmroje te vendi që është, qe ku e ki prokurorin në Gjilan, shko lajmëroje, nuk ki çka me ma dhanë mu përgjigjen, se unë nuk jam për me shku me qu në prokurori, se unë nuk e di që është shtru, a ti në qoftëse është shtru, shko paraqite menjëherë paraqite, jo me lanë që 2 vite a 1 vjet sa është bë kjo punë, ti nuk je më kundërshtar se unë i kryetarit po nuk është qashtu qysh po thuni kryetari nuk e ka bë këtë, kryetari ka bë punë, mos kujto që s'ka bë edhe pse unë jam kundërshtari i tij, që unë jam i pari, amo qysh jeni tu thanë ju, ai nuk paska punu kurgja, ajo nuk është e vërtet, nuk jam tu than në kundërshtim tanin, por si grup parlamentar ju krejt zi për neve është. Na atëherë s'kemi punu asgjë, ne nuk duhet me u kanë këtu asnjë edhe unë jam kundërshtari i tij. Belivalla, mos me u kanë në rregull pa i thënë në sy nuk e lë.

**z.Jakup Demiri:** Basri, ne mundemi me shku me vizitu bashkë, asfalti është aty, nuk është sen që harxhohet, shkojmë i kqyrem në oborr e ka, ndesh dërgoje në prokurori, ndesh ku dush, unë pak edhe nuk e kam zanat me u marrë me prokuroria e sene. Aty edhe kanë bë njëfarë shpronësimi, po ai asfaltin e ka në oborr.

**z.Basri Syljemani:** Me dal para mediave edhe me thanë që asfalti është në oborr, e ti nuk e qon në prokurori, atëherë ty duhet me të qu në prokurori, jo ti jo ai ka me shku qashtu është ajo.

**z.Jakup Demiri:** Ne duhet me fol, nuk është e thënë me mujt njërin në debat, se nuk ka të bëjë kjo me këtë logjikë. Unë jam tu e thanë publikisht para kamerave në kuvend komunal, unë nuk jam i s'mut psikik, aty është ai, shifet.

**z.Ali Bajrami:** Unë do të jem shumë i shkurt Jakup, e potencove, jemi të zgjedhur prej popullit edhe i përfaqësojmë interesat e popullit dhe qytetareve të Komunës së Vitisë në bazë të asaj që po e deklarojmë dhe po e diskutojmë, po flasë në emër të grupi LDK-së, atëherë ne këtu që jemi LDK kokmi keqpërdoruesit e buxhetit në bazë të asaj çka thave ti. Për PDK-në nuk po flas, flasin këta vet. Të vetmit ju si VV kokni ata që jeni tu e mbrojt paranë e taksapaguesve, që nuk qëndron, se të gjithë jemi të interesum që qëto taksa, këto investime të bëhen, të shtrihen në krejt territorin e Komunës së Vitisë, prandaj nuk është mirë me i përgjegjësu senet, nuk është mirë me u deklaruar se, shpëtimtarët e Komunës së Vitisë është grupi parlamentare i VV, kurse grupet tjera janë ata që po e mbështetin keqpërdorimin e buxhetit të komunës së Vitisë nuk qëndron kjo tjetra premtimet e mos realizuara Majlindë me ty po debatojë tasht kryetari i ka premtu 19 për mandatin 4 vjeçarë i ka publiku edhe GAPi mos realizimi i projekteve këtë bugjetë ne që e kemi votu ai buxhet është shpenzu është hargju në bazë të asaj ne që e kemi votu nuk ka pas tejkalime ose keqpërdorime dikushë ish marrë në pyetje tjetra që e ceke për punë që janë kry shumica jeni të pa kënaqur ti mundesh me folë vetëm në emrin tëndë atë ne qka mendojmë ne po e diskutojmë edhe po e shprehim para kamerave edhe para të gjithë të pranishmit, prandaj nuk është mirë me përgjithësu senet se secili këtu kemi ardhë me emër mbiemër tonë jo me emër të tjetër kujt.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Po të tregojë të drejtën kryesues sot ndoshta me i kursy për shkak edhe të rendit të pikave të ditës, të cilat janë shumë, e konsiderojë buxhetit i dhamë prioritet, por të gjitha janë të rëndësishme se nuk ka pikë që nuk e ka rëndësin e vet me gjithate dallimi i jem dhe i joti Jakup në qasjen politike është unë vrapojë deri në ditën e zgjedhjeve prej nesrit nuk kanë më kurrë edhe nuk vajtojë këtu dallojmë fiton ta japë dorën kam hupë, unë 2 here më ka mujtë PDK-ja të nesrit ja kam shtri dorën, urime kryetar, përhapër të koftë, jam ushtari yt dhe kështu veprohet ju këtë të metë nuk po mundemi me tejkalu më ka mujtë tu shtru asfalt, me ndriçim të ka mujtë, shtrije dorën 4 vite puno si këshilltarë këtu është problemi i jemi edhe i juvi as nu du me ju dhanë leksion, po për çdo ditë në çdo seancë në rast se përmendemi në fushatë e ka bë këtë shkojnë proceset përpara. Jam i bindur që edhe ti pajtohesh, ne duhet të japim propozim konkret. A e dinë ku ishte ironia ime, çka kam faj unë në vitin 2011 që e përmendi zonjusha apo zonjë, në rast se ti po fletë për ndriçim dhe trotuar dhe që vjen pikërisht prej Lubishtës dhe që e ka prej në Ramishtë deri në Lubishtë, i përmngjanë një qyteti as fshatit nuk i përmngjanë, duhet me pas pakë një etikë të këshilltarit.

A hecni apo nuk hecni, ne për banorë e kemi bërë. Thatë “Rrugën e Gjepav”. “Rrugët e Gjepave” janë 2, njërën e ki asfalt Lubishtë-Beguncë, tjetra tashti në anën tjetër është parapa dhe nuk duhet me u ndal. E kemi këtë nevojë edhe këtë se kemi plotë, nuk mund me thanë premtimet e kryetarit kthehet dhe thotë kërkesat e qytetarit, për çka ke me lyp llogari për premtimet e kryetarit, nuk jam që edhe kërkesat i kemi mbledh të gjitha me zyrën e informimit, nuk e di a është Musfata këtu në të gjitha dëgjimet që e falënderoj kryesuesin, se na u ka bashkëngjit, ju nuk jeni kanë aktiv hiq nuk jeni kanë aktivë si kuvend, edhe pse është dashtë me qenë, po nuk keni qenë për me dhanë kontributin e juv, por megjithatë gjithsecili qysh e ka pa veten krejt është bë një raport edhe i pjesëmarrjes edhe i kërkesave, edhe shqyrtimi i atyre kërkesave, në mesin e tyre ka pas plotë që kanë hy, ka edhe plotë që nuk kanë hy. Pozheran kanë kërku edhe zyre për kryetarin e këshillit të fshatit: a është kështu Ilir? Edhe ju kamë thanë, nuk hin kjo, se, unë nuk mundem me bë edhe pse është lokalitet i madh, por nuk ka mundësi të behet për momentin. A ka nevojë për një shtëpi kulture në Pozheran, askush nuk thotë që jo, a janë mundësitë, a kemi prioritet më të domosdoshëm se ato të nevojshme, kemi dhe ne duhet me vrapu me i kry ato të domosdoshme. Ato të nevojshme janë krejt çka të bëjmë sot leni rrugët veç korrigjome thotë, leni asfaltet dhe zhavorrin i drejtohet drejtorit, shtrojë rrugët me zhavorr në bujqësi nuk është kundërtënie kjo, a me të degju edhe qëtu qysh me të ndëgju ty nuk po jep propozime konkret ndëgjo, thotë leni rrugët shtrojë rrugët në infrastrukturë, por në bujqësi, prioritet në bujqësi tashti jep kryetari i komunës, ai e ka planin në qato 19 pika, 17 që i ka premtu, këta duhet me pas në rast se nuk e ka përfill drejtori që e lype rregulloren, e nderumja mundet me marrë kur të donë ka e marrë rregulloren e kqyr ju ka bë ndonjë padrejtësi, është komisioni drejtohet ja merr menjda që është shkel diçka aty, e qon lëndën në gjykatë, nuk është problem, institucionet fatmirësisht i kemi krejt, tashti a mundemi në mesin e 300 sa janë përfitues, se nuk e di as vet me pas subjektivizëm, nuk e përjashtoj mundësinë, mundet me pas, por në rast se veç 70% janë dhanë në bazë të kriterit, unë ja shtri dorën, nuk ndërtohet e ardhmja burra dhe gra po ju them tu e vajtu të kalumen, nuk ndërtohet, duhet me harru të kalumen. Tashti po nisemi në 2023 kur të vie kryetari me raport të vitit 2022, që është obligativ me ardh informata, atëherë i shohim krejtë se ke bë e ke bë por tasht me u marrë se çka ka pas thënë atëherë, si i ke fitu zgjedhjet, për mua është e panevojshme kur e kemi projekt buxhetin 2023.

**z.Jakup Demiri:** Nënkryetar, nuk ishim tu e disku tu ne punën e fushatës, edhe mos i jep kahje. Të ngova nuk të ndërhyra edhe mësohu me ngu këtu e kemi secili vendin që na e ka caktu tjetër kush për me i hi anej unë jam kanë me një debat në televizion vjet në fushatë e bëjshmi Vitinë më të bukur se Zvicrën, lokalitet i njëshme 24 lokalitet në Viti që në fund të tetorit eventualisht nëntor kanë me pi ujë qytetarët vet e ke thanë ka ingjizim edhe të kamë thanë, kur kemi dalë kemi pi kafe nënkryetar është shumë qekjo, po në rregull, e tash e ki gjendjen qysh e ki, a nuk është mashtrim me qytetarët qajo a , dikush duhet me të vlerësu nënkryetar se ki pozitë institucionale jo ti veten e dimë se qysh të kanë vlersu, po të thamë mos na maj ders qysh me u sillë edhe me hi në të kaluarën edhe tashë nashta edhe një të ardhme dika, por obligimi jonë është me bë këtë dokument sa më të mirë për atë ti përmendi të kalumet, se unë i dij defektet e kaluara sa herë ato 5 prioritet të fshatit Smirë i ke inkurporu ato projekte, asnjë nuk është kry, ti i ki në dokument qe 7 vite aty pse si ke bë për atë nuk e kam vullnetin unë me ardh më edhe ata nuk e kanë vullnetin mu marrë me ty. Unë e di që kryetari i ka 18 prioritet që i ka percaktu disa projekte për shkak të situatës që është kriju me ngritje çmimi, ne kemi mu ul me u disku tu për projekte që nuk mundem me u bë për shkak të telasheve që s’janë në dorën e komunës tonë, aty ka mirëkuptim, mirëpo edhe këto gjerat që kanë ndodh i dimë se qetu jetojmë sa njerëz me kontrata mbi vepër i ki jashtëligjshëm, a e dinë i ki 50 minimum çka i di edhe nja 200-300 i ki. Ne qetu jetojmë qëtu në Komunë të Vitisë, pastrues teknikë me u kanë është telashe me hi pa u marrë. Unë reagoj edhe për 5 euro, unë flas e mandej nuk lëshoj hiq, se e di që sun mirrna vesh me ty ndryshe. Qëkjo është dokument du për qata e du shumicën e investimeve kapitale 90% unë jam percaktu ku kanë me shku se tana nesër me shkojnë te dostat, te vota më shkon Ali koleg, më shkurt unë e kam edhe një hallë tjetër, e kam thënë edhe shumë herë e kam hallin më të madh me pjesën më të madhe të asamblesë komunale. Më vjen keq se i kam kolegë të gjithë po merren pakë me materialin shumë sinqerisht, e thamë pak e lexojnë materialin por nuk jeni në mesin e tyre, ti je shumë i informum për materialin, ama kemi ne gjera që votojmë shumicën

që pajtohen as pa e lexu as pa i bënë analizë ne kemi votu dokument edhe pa e parë hiq, besojë kogjo të rëndësishëm unë flasë në emër të grupit parlamentarë të VV edhe temin nuk thashë për të gjithë edhe në mesin temë shumica e asamblistëve këtu nuk ta lexon materialin nuk është në rregull kjo punë nuk është personale mundem me u kanë edhe i gabum edhe mos me ditë po unë mundona me dhanë kontributin për aq sa mundem edhe dijë. Faleminderit!

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Veç një po them, nuk është përgjegjësi e asnjërit për njeri tjetrin sa e lexon mundemi me lexu mos me kuptu, mundemi me kuptu gabim, këto janë çështje tjera, së paku në mesin e këshilltarëve nuk ka nevojë këto gjera mu diskutu, ne jemi në bazë të ligjit pikën për miratim të buxhetit qeverisja komunale me gjithë punën e vetë që e bënë e ka për detyrë me na e pru neve një formë se si e shef buxhetin me miratu ne mundemi ta diskutojmë sado buxhetin dhe në fund me qitë në votim u ngritën shumë pyetje, shumë shqetësime që lidhen besojë drejtori i financave tash e ka fjalën që do ti jep disa përgjigje të cilat u kërkun.

**z.Ali Bajrami:** Do të jem shumë i shkurtë. Në mandatin e kaluar drejtorë i LDK-së keni qenë edhe në përbërjen e kalume, pikërisht për këtë, por ai kur e ka deklaruar atë nuk ka thënë vetëm për LDK-në, por ka thënë shumica e këshilltarëve vinë pa e lexu materialin hiq e dini reagimin e këshilltarëve çfarë reagimi kam pas se nuk mundet kërkush me ditë në mendjen e tjetrit çka ka Jakup me thanë fyerje po më doket fjalë e rand.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Jakupi nuk na tha LDK nuk e lexon, por tha anëtarët e kuvendit.

**z.Ali Bajrami:** Tha shumica e këshilltarëve vinë pa e lexu materialin, nuk është mirë se pjesa dërmuese, po unë po thamë krejt e lexojnë se kur kemi hi në garë edhe kur kemi fitu jemi qëtë të votum të popullit jemi edhe për me mbrojtje interesin e qytetareve nuk jam për etiketime, nuk jam për me bënë debat për këtë çështje por nuk u deklarove. Mirë, unë po të kërkojë falje edhe në emër tem edhe në emër të grupit.

**z.Jakup Demiri:** Po ju përgjigjina kështu. Ky është shqetësim i jemi të tregojë shumë sinqerisht nuk është që e kam atë dert më, se na me të vërtet pak materialin e analizojmë, ndoshta është në krejt Kosovën nuk i kam që jam tu e fy kanë, por është shqetësim i jemi.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kjo i tejkalon çështjet tona çka na takon me vlerësu njëri tjetrin.

**z.Taulant Haxhiu:** Jakup, unë të kamë kolegë edhe kemi raporte të mira, po gabove, se ti nuk mundesh me ditë kurrë kush e lexon materialin kush se lexon. Ti mundesh me fol për grupin tanë parlamentar, por për krejt grupet parlamentare nuk mundesh me ditë. Ndoshta te ju e keni ndonjë hierarki që duni me ditë njëri shoqi kush e lexon kush jo, po ne i kemi secili njeri që vjen këtu edhe që ka marrë votën e qytetarit e ka lexu materialin. Ti nuk mundesh me fol në emër të krejt kuvendit, po mundesh me fol vetëm ne emër të grupit tanë parlamentar. Faleminderit!

**z.Jakup Demiri:** Në emër të kuvendit Taulant nuk mundet me fol askush. Kur të flasë unë mundesh me ngu se edhe unë e kam hapësirën teme. Unë e përfaqësoj veten edhe grupin parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje edhe prapë po thamë, ai shqetësim nuk është që vetëm e thashë, po perime është shqetësim i jemi ky kemi një pjesë po qëndron.

**z.Majlinda Shabani:** Këtu diskutimi më i madh bëhet ku ka qësi diskutime, jo kur të është për projekt buxhet që është seni më i rëndësishëm i komunës. Fillimisht po du me pas qasjen pak më të butë, po më pengon shumë qasja e gjithsecilit prej juve, sidomos prej nivelit ekzekutivë, se këtu ti je e re në asamble e këto propozimet ti marrin si të mirëqena knej thotë kryeatri hajde propozomë ti mu se qysh po do me zgjidhë problemin kur unë propozojë, ky thotë, po drejtori i bujqësisë e ka një plan program që shkon. Mos mu arsyeto mu nënkryetar, arsyetohu te qytetarët që premtimet që janë bënë në kohë fushate nuk janë realizu, e kryetari është dashtë me ditë se çka po premtun, po një problem shumë i madh është në komunën tonë, që komuna jonë përnime është hall mbi hallë, edhe kur foli shefi i grupit që tha po fol në emër tem, unë këtu përfaqësoj qytetarët edhe për mu janë shumë prioritet edhe shumë janë me i pa gjërat qysh realisht duhet me i pa e jo me majt anime politike, kështu që të lutem këto çështje edhe këto diskutime që i kemi me qenë më nivel. Faleminderit!

**Drejtori i Bujqsisë, z.Naim Pira:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Nuk e pata ndërmend me marrë fjalën me diskutu, por unë fillimisht po ju them kam pak vërejtje në udhëheqje e seancës, po ta them në mënyrë kolegjiale se, kam qenë për dy mandate kështu nuk mundemi me leju fillimisht ne debatin në mes të këshilltarëve komunal me fol prej vendit është një rregullore e kuvendit i cili e përcakton rregullat e kuvendit edhe diskutimit edhe të replikës në këtë formë mundemi me shku deri në mëngjes tu i reagu njëri tjetrit prej bankës që s'po me pëlqen mua të them të drejtën. Tjetra, u anatemu praktikisht shumë deri tash nga zonja këshilltare, që unë e vlerësoj kontributin, e vlerësoj përkushtimin e saj për çështje të bujqësisë. I mirëpres propozimet e saja të cilat vërtet mund të implementohen, pse jo, sepse fundi i fundit Drejtoria e Bujqësisë është e qytetareve të Komunës së Vitisë, por unë nuk mund të pajtohem me këtë që thotë, unë në teren kam pas vërejtje nga unë kur unë si Drejtori e Bujqësisë ndarjen e subvencioneve nuk e kam pas pothuajse asnjë ankesë, përpos njërit i cili ka qenë i motivum politikisht. Po ju them me plotë kuptimin e fjalës, politikisht, sepse i kam pa edhe sjelljet e zotërisë në teren edhe i kam pa takimet me njerëzit dhe për ironi te fatit njeri e ka dokumentin e falsifikum dhe kur i kam thanë, dëgjo ti je me dokument të falsifikum se prona nuk është në emër tanë, nuk është as në emër të babës tanë, kurrë më nuk e kam pa te zyra, krejt çështja është mos i motivoni njerëzit politikisht për çështje të tjera, sepse jemi duke bërë përpjekje si Drejtori e Bujqësisë edhe pse e kam një staf që e thamë me plotë të drejt që, duhet me pas shtimin e njerëzve aty, sepse është me prioritet, por nuk kemi pretendime mi nda njerëzit as në baza partiake, sepse bujqit janë bujq dhe ata punojnë me nder me mbet gjallë, prandaj ju kisha lutë vazhdoni me pikat e rendit të ditës se nuk kemi deri mëngjes kohë me nejtë tu e ndëgju njeri tjetrin. Kërkojë falje edhe një herë kryesues.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Faleminderit! Megjithatë është çështje e buxhetit, është shumë e rëndësishme 1 orë e 40 minuta i kemi bërë tu diskutu për buxhet, nuk kemi bërë shumë kohë ju kam dhënë hapësirë kush sa ka dashtë me fol, sepse te buxheti është pikë shumë me rëndësishme. Mu me vjen keq kur e kalojmë atë piken çka kemi me fol, edhe himi pak mes veti vetëm ajo më prek për çështje të tjera unë jam ok, edhe kur nuk e qëllonjë nuk do të thotë që me qëllu krejt, mirëpo dikush një propozim mundemi mi nxër me te mira.

**Drejtori i financave, z.Besnik Imeri:** Pyetja e parë ke për rregullimin e ujësjellësve. Këtu në listë janë diku rreth 300 mijë euro, gjithashtu për shtimin e kapaciteteve të ujit në Letnicë prej këshilltares që ishte pyetja e kemi diskutu edhe në KPF që është lanë si kodë edhe pse këtë vit kemi shumë mjete të cilat po mundohemi ta gjejmë mënyrën për me i shpenzu edhe me i investu në rritje të kapaciteteve, por për siguri e kemi lënë si kod nuk janë as pak as shumë 40 mijë euro i kemi lanë si kodë të veçantë që edhe me participu me projekte nëse kemi investime të tjera të agjencioneve të ndryshme në rritjen e kapaciteteve të ujit. Tek rritja e subvencioneve për bujqësi dhe për kulturë, kufijtë kanë qenë kaq edhe ne jemi të kënaqur që na i kanë pranë këto kufi ministria.

**z.Taulant Haxhiu:** Po në qoftë se kyqet edhe Stublla atëherë mund me ndodhë që Vitia mundet me met edhe pa ujë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Dilem nuk ka, unë kam spjegu edhe ne komunitet, po ti nuk je kanë, është kanë Beka, veç po ta jap si informacion, ne i kemi 230 mijë euro që po i frigoj që do të na shkojnë suficit për shkak se prona ku është fabrika e ujit në Letnicë është pronë e një kroatit ju keni qenë dëshmitarë që ja kom pru propozim vendimin më shpallë zonë me interes të përgjithshëm kam bërë përpjekje përmes priftit me gjet s'un e ka gjet, tashti më ka tregu ai kandidati për këshilltarë që e kemi pas i Stublles mos ma ra në kontakt me një të afërm të tij i cili është në Kroaci dhe po na shkon procedura shumë ngadalë megjithatë edhe ata atje që tregova në fillim CDI-ja me Hidromoraven nuk janë kanë në gjendje me i hy atij procesi. Unë kam qenë 4-5 here, kam shti edhe njerëzit ekspert të cilit mundem me ma dhanë idenë, më kanë thanë duhet me shpërngul këtë rezervarë, se dikun rezervari ish 1.5 kilometra poshtë fabrikës ai rezervar kur është ndërto në bazë të historikut, kanë thanë Vitia i ka pas dikun 300 shtëpi, tash Vitia është shumë e madhe dhe ma kanë dhanë idenë se atë rezevar me qitë afër fabrikës. Për me qitë afër fabrikës po duhet me shpronsu në atë vend edhe ndoshta tashti edhe prurjet e ujit nga burimet që i marrim janë më të mëdhaja se kapaciteti i fabrikës që i bën filtrimin e saj, prandaj në këtë kontest ne i kemi pas nda 230 mijë, se në marrëveshjen të cilën e kemi nënshkru se kam qenë edhe unë prezentë ish drejtori i "Hidromoraves" se bashku me ingjinjerin

e "Hidromoraves" të nivelit Gjilanit edhe CDI-ja kanë pas marrë përsipër me të projektin edhe me i hi kësaj çështje, megjithatë nuk është bërë ajo punë.

**Drejtori i financave, z.Besnik Imeri:** Për numrin e punëtorëve Nexhat, veç i jek 3 inspektorët e Drejtorisë së Inspeksionit edhe të bjen numri i saktë. Edhe nëse ne kemi gabu, definitivisht ministria nuk na kish leju me këtë gabim me vazhdu.

**z.Nexhat Halili:** Nëse janë 1161 2022 i ki edhe 6 1167 minus 3 1164 a ti i ki 1165.

**z.Berat Zuka:** Janë të zbritur nga 1161, 3 inspektorët, 6 mjekë janë futë te shëndetësia. Është edhe një punëtorë i IT-së në kuadër të Drejtorisë së Arsimit. Kur ti marrësh të gjithë këta, na jeshin me minus 1 punëtorë, mirëpo politikat e nivelit qendror kur e kanë bërë barazimin na i kanë përcaktu që, Komuna e Vitisë edhe pse i kemi pas zbritje në kornizën afatmesme buxhetore prej 606 nxënësve nuk e ka bërë zbritjen te Drejtorja e Arsimit, për shkak se pritet aty të ardhmen që të hapen çerdhet dhe kur ta marrësh totalin, Nexhati e ka mirë se, është minus 1, mirëpo ne nuk kemi pas mundësi ta kundërshtojmë komisionin e grandeve, se është përcaktu në komisionin e grandeve, se është përcaktu në kuadër të Ministrisë së Financave.

**z.Nexhat Halili:** Teknologjisë informative te cila drejtori e ki.

**z.Berat Zuka:** Te arsimit.

**z.Nexhat Halili:** Te arsimit okej, se te arsimit i ki 2 minus drejtores prej vitit të kaluar 2 pozita.

**Drejtoresha e Arsimit, znj.Fatbardha Emini:** Komisioni i grandeve që është në kuadër të qeverisë që përcaktohet edhe prej kryetareve të komunave, për me balancu është kanë politikë e re që është inkurporu në draftë buxhetin e 2023, disa komuna kanë numër më të madh të nxënësve dhe kanë pozita më të vogla dhe është diku një mesatare mbi 300 pozita i janë marrë komuna që kanë tepriçë. Përshembull ne në arsim i kemi 238 kjo graviton në muaj në muaj, ndryshon për shkak ramjes së numrit të nxënësve, por si pozita Nexhat nuk na i kanë marrë i kemi në buxhet për fat të mirë ne edhe në 2023 kemi me i rujt këta mësimdhënës që i kemi, sepse me grandin specifik 21.3 nxënës është 1 pozitë, edhe tasht si politikë e re për 2023 është vetëm një IT, disa komuna ka më shumë, por 40 IT-j janë në krejt Kosovën të aprovum, ndërsa komunës së Vitisë i ka taku një IT. Ju e keni pa tepriçën e mësimdhënësve, nuk jemi tu i largu, por jemi tu i marrë psikolog mësues mbështetës, drejtime deficitare që kanë nevojë, por për fat të mirë edhe 2023 i kemi në buxhet stafin aktual në arsim.

**z.Nexhat Halili:** Më vjen mirë në përgjigjen drejtoreshë, po unë e kam bërë një krahasim në mes kornizës afat mesme buxhetore të cilën e kemi elaboru në seancën e kaluar edhe aty i ke pas nëse nuk gabojë 825 me 827 827 2022 kurse 825 i ki tash ti iki minus. Tashti edhe te buxheti kur është minus është për qëta 2 punëtorë, mirëpo tash esenca e gjithë kësaj është tash po del një minus. Unë kam bërë pyetje, ju jepni përgjigje për qet arsye ne jemi qëtu.

**Drejtori i financave, z.Besnik Imeri:** Tek parkingjet publike që the, është planifiku kjo rrugë ka qenë e planifikume mu dhanë me tender publikë, rruga kongresi manastirit, nuk është përfudnu rruga për shkak të vonesave të çmimeve. E dini tek rruga e Sllatinës vërejtjet që i ki në prokurim nuk i di unë ato, mendoj që duhet me i drejtu në prokurim, për shkak të procedurave, ndërsa për çmimet që i kanë, çmimet i vendos tregu, oferta edhe kërkesa, është ligji i parë i ekonomisë. Të hyrat vetanake, kufijnet na i përcakton ministria edhe për realizimin e planit që e kemi pas plani për vitin 2022 është kanë 987 mi e 868 euro realizimi deri në Janar-Gushtë është 695 mi 790 euro e 97 cent apo 70.43%, kështu që të hyrat vetanake janë planifiku dhe janë vendos kufijt në bazë edhe të viteve të kalume edhe të këtij viti të cilat i kemi inkasu. Listën e rrugëve, unë i kërkoj falje Liridonës që në KPF i kam premtu edhe i kam bërë gati, nuk i kam me vete, mas pauzës janë lista e rrugëve me zhavorr lista e rrugëve rurale, lista e trotuareve me ndriçim, listat përfundimtare të cilat janë nënshkru edhe kontratat pas pauzës ti sjell, se nuk i kam me vete.

**z.Nexhat Halili:** Pse nuk i keni parapa të hyrat nga qiraja lokalit te shëndetësia.

**Drejtori i financave, z.Besnik Imeri:** Janë bartë te shërbimet publike.

**z.Nexhat Halili:** E keni edhe tatimin në tokë, a parashihni tatim në tokë për 2023

**Drejtori i financave, z.Besnik Imeri:** Më falë kryesues atë problem e kemi edhe prej ministries sotë paradite e kemi diskutu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Propozimi i buxhetit nga qeverisja komunale është ky propozim, që ka ardh. Ju falënderoj për diskutimet për idetë, kërkojë që në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, që buxheti duhet del në votim dhe me shumicën e thjeshtë të prezentëve që janë këtu buxheti kalon. E rëndësishme është që miratimi i buxhetit të jetë sa më i mirë, se nga ky buxhet afër 15 milion që jemi tash varen edhe projektet edhe rrugët edhe gjithçka që lidhet me vitin fiskal që vjen. Parimisht nuk do të thotë që taman jemi të kënaqur edhe ne, se nevojat janë shumë më të mëdha. Besoj që edhe ne kemi pas shumë projekte të tjera që kemi dashtë me i shti, por e rëndësishme është që për vitin e ardhshëm të planifikohen edhe çerdhe edhe në 4 fshatra ujë të planifikohet shtëpi për persona me aftësi të kufizuar, planifikohen bejagi disa projekte që nuk kemi mundur më herët t'i realizojmë. Unë si kryetari i kuvendit kisha kërku nga të gjithë ju, që ta votojmë këtë buxhet. Kush është për me ngritje të dorës që të miratohet buxheti? 13 për. Kush është kundër? 8 kundër. Abstenim nuk ka, domethënë miratohet buxheti.

**z.Jakup Demiri:** Kryesues, nëse të kujtohet që ne KPF u mirrev vesh që të vimë në kuvend komunal, do të flasim rreth kërkesave tona, kështu që i kemi qëto pikat, nuk e di a nuk tu kujtua apo nuk e pe te arsyeshme që me ja dhanë fjalën drejtorit të financave edhe me kqyrë se a mundet me hi ndonjëra prej pikave të Lëvizjes Vetëvendosje në buxhetin. Të gjitha komunat besoj që më ndryshe e bëjnë këtë, edhe më herët kur ka qenë kryesues Naim Pira, po atëherë zakonisht kemi diskutu më shumë në KPF. Ksaj radhe nëse të kujtohet në KPF u merrem vesh për rekomandimet e tona do të diskutojmë në kuvend komunal. Ne i dhamë disa rekomandime, nuk u diskutu hiq a ka mundësi ndonjë me hi a jo.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Për çdo keqkuptim kërkoj falje, mirëpo deri tash diskutum edhe besoj që aq shumë e shterëm debatin edhe për atë kërkesë që cilat janë kërkesat. Përgjithësi u bisedu në forma të përgjithshme, konkretisht nuk e pata asnjë kërkesë, atëherë shkojmë në pushimin e drekës.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pra po fillojmë më pjesën e pasdites të seancës së rregullt.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

### **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjobë për vitin 2023**

**Drejtori i financave, z.Besnik Imeri:** Përshëndetje! Përsëri prej komisionit për Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Unë e kam një ndryshim prej Drejtorisë së Shërbimeve Publike, neni 12, pika 1.4 për shfrytëzimin e hapësirave publike pranë ndërtesave për aktivitete biznesi për rahatën e klientëve, kafiteri, restorante, duke i ndarë në zona. Zona e parë 2 euro për metër katror, zona e dytë 1.70 euro për metër katror në muaj, zona e tretë 1.50 euro për metër katror në muaj, zona e katërt 1.2 euro për metër katrorë në muaj. Në këtë zonë përfshihen të gjithë fshatrat e Komunës së Vitisë, pika 13.3.16 vendosja e shtyllave elektrike në pronë publike do të jetë 30 euro neni 42 do të jetë ndryshime te 40 do të dënohen për kundërvajtje personat fizikë dhe juridikë me gjobë për shkelje të dispozitave të rregullores mbi taksa ngarkesa dhe gjoba pika 40.1 me gjobë prej 500 deri 800 euro do të dënohen për kundërvajtje personat fizikë ndërsa 1000 deri 1600 euro do të dënohen për kundërvajtje personat juridikë nëse vepron në kundërshtim me nenin 12 pika 1, pika a b c d dhe nenin 12.1.2 të kësaj rregullore.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kështu i kemi në material të njëjta se si i lexove.

**Drejtori i financave, z.Besnik Imeri:** Mirë në rregull, ndërsa sot e kemi kërkesën prej Drejtorisë së Inspeksionit, z.Adnan Ymeri, kemi disa ndryshime.

**Drejtori i inspeksionit, z.Adnan Ymeri:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba, për shkak të centralizimit të disa shërbimeve që kanë ndodhur në Drejtorinë e Inspeksionit, tek Agjencia Veterinës dhe Ushqimit, konkretisht në bartje të inspektorëve, inspektorët sanitarë të bujqësisë dhe veterinarisë, disa shërbime tash e tutje ne nuk mundemi të kryejmë dhe nuk mundemi t'i taksoj administrativisht dhe për këtë arsye edhe më herët e kemi cek, mirëpo këtu sigurisht ka ndodhë ndonjë gabim apo lëshim pa dashje dhe prapë janë të parapamë konkretisht neni 26.11. Taksa për pëlqim higjienosantar për

të gjithë operatorët shëndetësor duhet të hiqet, neni 26.12, taksa për pëlqime fitosanitare për barnatore bujqësore , 26.17 lëshimi i çertifikatave për transport të kafshëve të gjalla brenda territorit të Komunës së Vitisë edhe 26.18 taksa për kontrollim të mishit për krerë. Të gjitha këto tash e tutje kanë kalu te Agjencia e veterines dhe ushqimit edhe inspektorët i kryen punët prej agjencisë dhe veterines, ushqimit. Kërkoj që të hiqen nga rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Drejtore unë po të kuptojë në centralizim të kompetencave por shtrohet pyetja taksat administrative dhe taksat komunale është një dallim juristat e dinë taksa administrative është shërbimi aty për aty taksë komunale është për hapësirën që e shfrytëzon edhe popullatën që e shfrytëzon të komunës tonë në raste se kemi raste të cilët bizneset tona kërkojnë një pëlqim të tillë un po i di që janë inspektorët atje por qajo taksë a e vjelin krejt ata dhe a pajisen ata me dokumente duhet ta sqarojmë se kjo ka më të shërbye për 1 vjet.

**Drejtori i inpeksionit, z.Adnan Ymeri:** Tashti dallojnë rastet kur kemi kërkesë për pranim teknik të lokalit, e cila kryhet nga inspektorët e tregut. Më herët do të thotë kërkesë për pranim të lokalit dhe higjenosanitari u kry prej 2 inspektorëve, tash do të thotë kryhet vetëm prej inspektorit të tregut. Ne prapë e kemi taksen për pranim teknik të lokalit, mirëpo taksen për pëlqime higjenosanitare.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Çertifikaten për transportimin e kafshëve kush e lëshon.

**Drejtori i Inpeksionit, z.Adnan Ymeri:** E lëshon tashti agjencia për veterinë dhe ushqim.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Edhe prodhuesit që janë në Viti.

**Drejtori i inpeksionit, z.Adnan Ymeri:** Edhe prodhuesve se ajo është regjionale, këtu nuk kemi pjesë të hyrat, sepse janë bartë të agjencia e veterines dhe ushqimit.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Ti ki përshembull sektorë shumë që janë e ki njërin me 100 krerë dele dhe ai shet qingja dhe tash shumë e pakuptimtë krejt taksen me naj marrë atje Gjilani. Unë nuk jam për me tejkalu atë propozimin tënd.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ne do ti përmbahemi çështjes si e ka parapa çështje ligjore. Te pika 26.17 veç po shkruan që çertifikata e transportit të kafshëve të gjalla brenda territorit të Kosovës 20% e shumës brenda vitit të akumuluar kthehet në buxhetin komunal. Atëherë 26.17 nuk e heqim.

**Drejtori i Inpeksionit, z.Adnan Ymeri:** 26.17 mundemi me leju me vazhdu, domethënë mbesin 3 pika 26.11, 26.12, 26.18. Faleminderit nënkryetar për kjarësimin.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba parasheh mbledhjen e të hyrave vetanke dhe kjo ka qenë në diskutim publik në seancën e mëhershme. Kjo shkon edhe me buxhetin që duhet të miratohet, që është i parapamë. A ka dikush me diskutu lidhur me këtë rregullore.

**z.Ali Bajrami:** Drejtor, u cek ndryshimi që është ndryshim ligjor. Kërkesat për dokumentacion edhe inspektorët që i ceke a do të janë në Komunë të Vitisë apo fermeri ose qytetari duhet me shku në Gjilan për me apliku për këtë dokumente në tjetrën çka e kam këtu në këtë rregullore për ngarkesa dhe gjoba i kemi edhe tarifin në të cilat ngarkohen bizneset a do të votojmë që prapë me i liru apo do të votojmë për mi apliku se deri tashë praktika është kanë që i kemi liru edhe këtu një sqarim në këtë rregullore që e kemi para veti do të votojmë prapë me i liru bizneset prej këtyre ngarkesave.

**z.Jakup Demiri:** Pyetja tjetër është te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, te neni 8.1.4, faqe 4, dhënia në shfrytëzim e galerisë se arteve për 50 euro, unë kisha dashtë që me cek nëse është në pyetje për student edhe për disa piktorë që i kemi në Komunën e Vitisë me lanë me një shumë simbolike 10 euro ose me i liru prej pagesës, se ka studenta që i kemi në artë dhe me ja u mundësu me shfrytëzu pa pare këtë sallë kur kanë ndonjë ekspozitë të veten, ato edhe ndodhin, po po them që me taksu edhe tjetra që e potencoj Aliu, unë nuk po e potencoj hiq se po e marrë përgjigjen e njëjtë.

**z.Taulant Haxhiu:** Unë kërkoj që inspektorati të jetë pak më vegjilent, sidomos keqberësit, shkatërruesit e pronave publike, hedhësit e mbeturinave vend e pa vend t'i gjobisim ashtu edhe e paska titullin rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Unë e kam një vërejtje të pazari i gjelbër, 1 muaj e kemi mbajtur bajrakun koga mirë nuk kemi lanë me dalë në rrugë ata te tregu me dal me blloku rrugën 1 muaj mas 1 muje ata prapë kanë dalë në vendin e vet. Unë po shoh që aty po hedhin mbeturina sidomos në ditën e enjte kur është pazari po

hudhin mbeturin për rreth rrugës dhe po e bllokojnë qarkullimin e njerëzve në I muj jemi kanë striktë i kemi qu njerëzit të cilët punojnë dhe veprojnë brenda. Tashti kanë dalë krejt për rreth rrugës komplet njerëzit që veprojnë ditën e pazarit, janë krejt te rruga, ata po e pengojnë edhe lëvizjen e lirë të qytetarëve.

**z.Remzi Salihu:** Unë deshta një shpjegim këtu të neni 5, të Drejtorisë së Administratës ku parashihen çmimet për certifikata. E këto vërtetime tjera të 5.15 dhe 5.16 thotë vërtetimi për shtetasit tanë me punë dhe vendbanim jashtë Kosovës, 3 euro për parashtrim të kërkesave, 1 euro cilët janë këta vërtetime apo me çfarë vërtetime kemi të bëjmë dhe për çfarë kërksa, se kërksat mund të jenë të ndryshme nëse është e njëjtë për lëshimin e vërtetimeve për personat që banojnë në komunën tonë është 2 euro, atëherë për shtetasit jashtë Kosovës, për prindit tanë apo të afërmit tanë që jetojnë jashtë, pse të jetë 3 euro. Po më duket mos po i sanksionojmë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Unë po mendoj se kemi shumë shtetas tanë të cilët gradualisht e kanë marrë edhe shtetësinë, ndoshta disa duhet me liru shtetësinë e Kosovës se janë në Austri nëse e kanë shtetësinë austriake, këtu duhet me liru dhe ndoshta është për këtë, nuk është drejtori i administratës këtu.

**Drejtori i inspeksionit, z.Adnan Ymeri:** U parashtrua edhe një pyetje prej këshilltarit Ali Bajrami se, kërkesa ku dorëzohet tani e tutje kërkesa dorëzohet në Agjencinë e Veterinës dhe ushqimit dhe ata e fillojnë procedurën administrative në bazë të kërkesës, ka rast që qytetarët lajmërohen edhe në Drejtorinë e Inspeksionit në drejtorin tonë dhe nuk hezitojmë edhe ne ju ndihmojmë, i thirrjmë inspektorët për çështje të ndryshme për të cilat do të thotë ata kanë nevojë, ndërsa lidhur me çështjen e tregut dhe shfrytëzimit e hapësirës publike që e kanë shfrytëzuar ditën e enjte ditë pazari që I thonë në Drejtorinë e Inspeksionit atë çështje e ka të rregulluar, domethënë më nuk kemi leju përshembull operatorët me shitë në pronë publike apo edhe në tretuar nuk I kemi leju përjashtimisht disa që I kanë pëlqimet e pronarëve privat të familjes dhe ata dalin shesin produkte bujqësore as ne nuk jemi me I ndalu këta fermer që shesin produkte të imta, mirëpo është shuma e rëndësishme që hapësira publike të ruhet të mbahet a pastër dhe rruga mos të nxihet. Ai ka qenë një veprim shumë i duhur që e kemi ndërmarr të tregu dhe tashti nuk ka problem edhe këtë të enjte kemi dal kemi asistua ata të cilët kanë refuzuar, I kena gjobitë nëse ka pas nevojë kemi shqiptu edhe gjoba të ndryshme në Drejtorinë e Inspeksionit ka shumë që kena shqiptu gjoba, sidomos edhe te mbeturina I sheni edhe në informatën e kryetarit e ki publike.

**z.Taulant Haxhiu:** Dëgjo, unë nuk kam qenë aty për hirë të korrektësisë disa që banojnë atje bashkë në atë pjesë, po e di për kanë e kam fjalën. Ai më tha këto fjalë që po ti them unë decidimisht kështu, tha I muaj e kanë mbajtur bajrakin, mas I muje ka fillu prapë si herat e kaluara ju pe dini edhe për cilën person bahet fjalë.

**Drejtori i inspeksionit, z.Adnan Ymeri:** Zotëri Taulant për çdo diskutim je i mirëseardhur.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë para se me qitë në diskutim, mendoj që propozimi i Jakupit ka vend që të shtohet këtu që për studenta që paraqesin promovimet.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Mundeni me shkru me rastin e paraqitjes së dokumentin që e identifikon që je student, salla do të shfrytëzohet pa pare, kjo vlen edhe për nxënësit.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Bëje 8.1.4.1 kjo mbet a dhe b, me ngritje të dorës: a jeni që të miratohet me largimin e atyre pikave që drejtori i propozoj dhe me propozimin e Jakupit, kush është për? 19 janë prezent, 19 pro kundër, nuk ka abstenim, nuk ka. Faleminderit shumë!

Si pikë të katërt kemi:

#### **4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2023**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Edhe plani ka qenë në diskutim publik, ka qenë edhe në seancën e parë, është edhe tash materiali ju ka ardh me kohë, parimisht ju kemi përmbajtur Ligjit në Vetëqeverisje Lokale, pikat që janë të domosdoshme kemi parapa edhe pika të tjera në bazë të provojës së kuvendit që është kanë deri tash dhe këtu nuk është gjithçka fikse, se ka mundësi që pikat të vinë në rend dite edhe jashtë planit, edhe me kërkesa të grupeve edhe me kërkesa të ndryshme që mund të jenë edhe pika të tjera, varësisht prej seancave I kemi pa edhe seancat tjera seancat e rregullta dhe mundë të mbahen seancat e urgjente dhe të jashtëzakonshme të

cilat janë të parapame edhe me ligje nese ka diqka me diskutu te kjo pikë nese nuk ka kisha kërku me ngritje dore kush është që të miratohet plani I punes kuvendit për vitin 2023, 20 pro 20 janë prezent kunder nuk ka abstenim nuk ka

**Si pikë të pestë kemi:**

**5. a) Nisma për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal e kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunën e Klllokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike.**

**b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit të nismës së kryetarit të Komunës së Vitisë me Komunitat e Klllokotit në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi, bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike. c) Propozim vendimin për autorizimin e kryetarit të Komunës së Vitisë për të filluar konsultimet me Komunën e Klllokoti në fushat e përgjithshme, si: infrastrukturë rrugore, ekonomi bujqësi, shëndetësi, shërbime të zjarrfikëseve, ofrimi i shërbimeve juridike.**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Parimishtë është e njëjta pikë që është nisë edhe kalonë deri te vendimi për me idhanë autorizim kryetarit që në bashkëpunim me kryetarin e komunës së Klllokotit pikat e përbashkëta që janë në interes të dy komunave në këto pika të ketë bisedime dhe të fillojnë për projekte të përbashkëta që është e nevojshme shumë shërbime edhe janë tu kry që janë nevojë e përbashkët mirpo parimishtë kërkohet një vendim që me vendim të jetë e parapamë a ka dikush për diskutim nese nuk ka me ngrite dore për kete piken 5 në 3 abc 20 janë prezent 20 pro kundër nuk ka abstenim nuk ka me 20 vota pro miratohet.

**Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:**

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale në zonën e kadastrale ne Viti, Radivojc dhe Sllatinë.**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Duke e pasur parasyshë që drejtoresha nuk është këtu zonë me interes të përgjithshëm e keni edhe materialin është fjala për pronat e AKPs është fjala për shkollën fillore Deshmoret e Vitisë , Varrezat e Deshmoreve janë disa prona që shfrytëzohen mirpo ne duhet ti shpallim në interes të përgjithshëm që këto prona mos me dalë në shitje nga AKP se nese nuk i ki në interes të përgjithshëm AKPja mundet me i qitë në shitje dhe kështu deri sa të bëhet një zgjidhje që këto prona të kalojnë në pronë komunale ne duhet kohë pasë kohe me i shpallë deri sa të është afati me i shpallë zonë me interesë të përgjithshem është fjala për Varrezat e Deshmoreve Shkolla Fillore Hidromorava janë parki në Sllatinë.

**z. Bekim Azizi kryesus i kuvendit:** Nese nuk ka për diskutim kisha kërku me ngritje dorës kush është për me 20 vota pro kundër nuk ka abstenim nuk ka me 20 vota miratohet.

**Si pikë të shtat të rendit të ditës e kemi:**

**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e komisionit, për intervistim, vlerësim dhe poentim të kandidatëve të cilët kanë konkurruar në konkurset publike për pozitë drejtor, zv drejtor të shkollave fillore-mesme dhe çerdheve të Fëmijëve të Komunës së Vitisë.**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ky është komision me mandat I vjeqarë që për një vitë të gjitha konkurset që janë për drejtorë zv drejtorë shkojnë përmes konkursit.

**Drejtoresha e Arsimit, znj.Fatbardha Emini:** është një procedurë që e kërkon udhëzimi administriv për zgjedhjen e drejtoreshave në institucionet arsimore që është konfrom ligjit mbi arsimin parauniversitarë dhe konfrom ligjit mbi qeverisjen lokale konsiderojë që është një procedurë që duhet me kalu e kërkon udhëzimi administrivë që komisioni të cilën e propozon ekzekutivi në këtë rastë drejtoria e arsimit të kalojë përmes kuvendit kryetari i komisionit duhet të jetë një zyrtarë i DKAs ashtu e thotë edhe udhëzimi administriv gjegjesisht neni 6 , 2 antar propozohen nga DKA dhe miratohen nga kuvendi komunalë antari i parë duhet të jetë i punsuar në DKA ndërsa antari i dytë i propozuarënga DKA është njeri nga ekspertet apo drejtorë i ndonjë institucioni arsimorë apo drejtorë shkolle kështu kërkohet dhe I perfaqgues i Mashtit udhëzimi tregonë qartë sa ditë para se të mbyllet konkursi ne duhet me njoftu ministrin e arsimit dhe ata zakonishtë na

dergojnë një ekspertë apo një zyrtarë që e kanë përcaktum për zgjedhjen e drejtoreshave është një procedurë që e njëjtin të gjitha komunat konfirmojnë udhëzimit administrativë dhe në nesë gjatë këtij viti shkollë 2022-2023 paraqitet nevoja me pasë zgjedhje të ndonjë drejtori në një institucion arsimorë atëher ta kemi komisionin në përbërje dhe në forme legjitime dhe mundet me fillu edhe me procedurat e konkursit.

**z.Jakup Demiri:** Drejtoresh ne i kemi emrat këtu por sa për hirë të transparencës është mirë të ditët të gjithë kush jan personalitetet megjithëse unë Izjadin Ahmetin e njofë por Vjollca Zejnullahu nuk e njofë.

**Drejtoresha e Arsimit, znj.Fatbardha Emini:** Izjadini është zyrtarë për arsim që udhëzimi e kërkon një zyrtarë të arsimit dhe është profil arsimorë udhëzimi ashtu e thotë ndërsa antarja tjetër është drejtoresha e shkollës Skender Emërllahu në Ramjan është e kualifikume me master edhe është e gjinisë femërore kështu që edhe nëse prej ministrisë ndodhë nuk na dërgojnë anëtarin tjetër gjinisë femërore edhe përbërja ka një balancim gjinorë që në rast dikush mundet prej kandidatëve me u anku të dytë janë të profilit adekuatë që kërkon udhëzimi administrativ dhe kanë kompetencë edhe profesionale edhe provojë institucionale për me bë përzgjedhjen e drejtoreshave në institucionet arsimore.

**z.Remzi Salihu:** Faleminderit kryesues! Unë veç kisha dashtë ta bëj një pyetje a jemi ka e zgjedhmi apo rizgjedhim Izjadin Ahmetin

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Parimisht komisioni ka mandatë 1 vjeçarë Izjadini ka qenë edhe në komisionin e kaluar por në Korrik ka përfundu afati i mandatit të kaluar se është 1 vjeçar tash prapë ka ardh se Drejtoria e Arsimit i ka 3-4 punëtor krejt nuk ka asnjë të profilit adekuatë mesa e di unë.

**Drejtoresha e Arsimit, znj.Fatbardha Emini:** Tash së fundmi në muajin shtator, Zyra e Burimeve Njerëzore e ka rekrutu edhe një zyrtarë tjetër që është profil arsimor por ne kemi fillu paraprakisht dhe Izjadini është i vetmi me profil arsimor edhe me provoj ne mësimdhënie ne Drejtorinë e Arsimit dhe nuk kemi pas asnjë herë as një konkurs që është prish nga inspektorati a po organet gjyqësore në atë komision ku ka qenë Izjadini e njëj këtë fushë dhe konsideroj që është kompetent për me qenë kryetar i komisionit.

**z.Bekim Azizi, kryesus i kuvendit:** Nëse nuk ka për diskutim kisha kërku me ngritje dorës: kush është për? Me 12 vota pro, kundër nuk ka, abstenim 8 vota, miratohet.

Si pikë të tete të rendit të ditës kemi:

**8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, me Nr. 01-110/05-790 të datës 01.08.2022**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Këshilltar të nderuar, ju e keni propozim vendimin i cili është kthi për herë të dytë, jam bind edhe unë që duhet me ardh për shkak se parimisht shumë vërejtje qe e kemi pas në këtë parimisht nuk kemi vepru drejt, sepse dy të tjerëve ju kemi dhënë ne kohëzgjatje tjetër, e këtë e kemi veçu dhe taman jam bind se me të vërtet duhet te sjellët edhe një here në kuvend e të punojmë njëjtë për të gjithë njësoj dhe arsyeja është kjo e arsye tjetër është ne të interesuar në kohëzgjatje të shkurt nuk do të ketë.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Hapi diskutim lidhje me këtë.

**z.Taulant Haxhiu:** Unë kam propozu këtu ne seancën e kalume qe të votojmë për 5 vjet, por e pash që ju kemi bë jo të gjithëve ja kemi dhanë 10 vite e nuk ka mundësi kush do që e merr barnatoren për 5 vjet ta bëjë një investim dhe atë investim ta kthej për 5 vite kështu si pjesë e komisionit që kam qenë kom propozu që të jete për 13 vjet.

**z.Jakup Demiri:** Ne e kemi analizu materialin edhe ne mbledhjen e grupit parlamentar ne mendoj se është shume 13 vite mednoj se ne 7 vite janë taman, mendoj qe është e paarsyeshme 13 vite.

**z.Nexhat Halili:** Unë tash po e shof këtë herën e parë kur është bë publikimi edhe kemi votu ne për propozim vendimi, i cili ka qen 3 vite, po për këtë është një një njoftim publik ku ju ka mundesu operatorëve ekonomik ose personave fizik te konkurrojnë okej nuk ka pas konkurrent u kthye ne seancë ne e kemi marr vendim për 5 vite, unë nuk po shof dikun kame hulumtu e nuk kam pa dokument që është dhënë mundësia operatorëve ekonomik me konkuru për 5 vite nuk e di ka e marrin këtë përgjigje se nuk ka pas të interesuar

kur ju nuk keni bërë kurrfarë njoftimi nuk ju ki dhanë afat e tash e kthen në seancë e kërkon 13 vite pa u dhënë mundësia operatorëve ose personave fizik me konkuru. Kjo ka qenë dashur se paku mu be përpjekja dhe mu vërtetu a ka të interesum apo nuk ka.

**z. Ilir Zuka:** Kryesues, unë në KPF thash se me ka pengu ajo qasja në seancën e kalume, kur ja nisem me u shty si në treg me qenë. Fillimisht e kemi diskutu se, është bërë një diskriminim se dikujt ju ka dhanë për 13 vite edhe unë pajtohem me Taulantin.

**z. Sejdi Emiri:** Vetëm duhet me ditë një sen që, për 13 vite shumë lëvizin senet edhe shumë zhvillohen bizneset. Mendoj që sot nëse e japim një pronë komunale me një çmim shumë të volitshëm pas 4-5 vite komuna mundet me përfitu me një qira ndoshta dupllo me ata çka e jep sot, gjithëherë duhet me i marr vendimet që janë në interes të komunës jo të individit kush do qoft ai unë mendoj që është e pa drejt në raport edhe me bizneset tjera që operojn me lëmin e njëjt që dikujt me ju mundesu një e drejt që me ju dhanë për 13 vite. Shumë është maksimumi 7 vite, mendoj sepse senet lëvizin.

**z. Remzi Salihu:** Do ta kemi parasysh se, në mbledhjen e kalume kemi diskutu kjo si mirë rreth kësaj teme. Po shoh që ka tendenca që edhe tash të hyj në pazare. Unë jam i mendimit dhe i pajtimi me propozimin e dy parafolësve të mi, që të jet 7 vite. U dhanë edhe arsye, po megjithatë të isha pyet unë personalisht nuk do të levizësh fare nga 5 vite, sepse kush janë ata që mund të na detyrojnë neve të ndërrojmë vendimet, jo me supozime. Ndoshta dikujt i konvenon 5 ditë.

**z. Ali Bajrami:** Këtë propozim vendim e kemi ndryshu që dy here. Unë nuk e di pse është ky insistim kur kemi mujt në propozim vendimin e par me u dakordu me marr vendimin e mos me na sjell në kësi pozita çfarë jeni tu na sjell tani për objektet dhe pronat komunale, a vendos komuna a vendos qytetarët pse po e thamë këtë. Unë e kam biznesin e jo valla nuk po me doket 5 vjet po ama për 15 vite ose 20 vite hala ma skandaloze që është për mua është arsyetimi se për 5 vite është pak se objekti ose hapësira do investim objekti është funksional, është tu funksionu nuk ka kurrfarë investimi se ai objekt është i QKMF-së edhe është në gjendje të rregullt që nuk i mungon kurgja prandaj nuk jam tu fol në emër të grupit jam tu fol në emër timin për këtë propozim vendim vot nga unë nuk ka.

**z. Durim Sylejmani:** Po më habit qasja e Taulantit, me kujtohet prej mbledhjes se kalume, ku Taulanti nuk pranojmë as 7 vite pa asnjë kusht se çka e ka shti me luft për një muaj 8 vite diferencë. Unë nuk e di, duhet mu kane një arsye e madhe, po këtë e din Taulanti.

**z. Taulant Haxhiu:** E kam propozu për 13 vjet, tu e pa se të tjerët shumica a bizneseve e kishin marr për 13 vite të cilët janë dhanë para këtij, e unë nuk deshta me e diskriminu vetëm një biznes, unë nuk e di kush e merr këtë, a e merr ti apo e marr unë, apo të tjerët, e se sa kam interes unë kurr njëjtë as nuk e njof personi që e ka ose që ka me e marr e unë nuk jam njeri i interesave.

**z. Remzi Salihu:** Nuk e di unë se kanë po e favorizojmë apo kanë po e ndëshkojmë në thjesht duhet të marrim një vendim, e biznesi i cili nuk ka interes mos të konkurron fare në e marrim një vendim që e shohim të arsyeshme unë nuk e votoj kështu si që është.

**z. Jakup Demiri:** Në njëherë këtë dokument e kemi votu. Unë nuk e di a ka dal në ankand publik apo jo, nëse nuk ka dal le të zhvillohet procedura njëherë tani e shohim.

**z. Bekim Aziz kryesues i kuvendit:** Unë nuk e di procedurat deri ku kane mrri nuk e di që ka dal në ankand mu me ka ardhë propozimi unë e kam sjell në kuvend edhe unë mendoj që është pak 5 vite, po si do që të jet ju vendosni.

**z. Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Mbetë në rolin e propozuesit, sepse drejtoresha nuk do të jet për disa ditë këtu dhe tash e kame marr si material, megjithatë një du me ja thanë në aspekt ligjor, nuk kemi as një pengesë pse e kemi prurë kështu a u dal në ankand, nuk është dal të interesuarit nuk janë të interesuar për këtë çështje e tha Remzia në muj me shpall e nuk konkurron kurrkush interesi i komunës është me marr qira se të hyrat vetanake bëhen kështu. Kuvendi duhet të diskuton ti shterr deri në fund këto debate.

**z. Nexhat Halili:** Nëse ky propozim vendim po kthehet mbrapa, na kemi votu në seancën e kalu për 5 vite, e le të shfuqizohet njëherë ai vendim tani votohet ky.

**z.Illir Zuka:** Nuk ka nevojë me pru me shfuqizu se këtu po thotë ndryshim plotësim i vendimit edhe provë pas fjalës teme thave këtu po lidhe pazare ne jetën tem, nuk e di se çka janë pazaret.

**z.Remzi Salihu:** Debati u shenderru thua ne pazar ne seancën e kalume. Nënkryetar, edhe unë jam të përfitojnë qytetarët e Komunës së Vitisë, edhe e kam me dije po megjithatë unë mendoj që nuk janë të gjithë të njëjtë që të mbajnë parime të njëjta, sepse secili ka specifikën e vetë, secila procedurë e ka specifikën e vet apo ankand e ka specifikën e vet, kështu që mendoj qe nuk jemi tu thy parime.

**z.Sejdi Emini:** Parimisht nëse dojmë me qenë ne interes të bizneseve të Komunës së Vitisë duhet mos me leju kerkan aty, se ne faktikisht në momentin qe e merr dikush ata aty ai është i privilegjum, se e dimë qe krejt shkojnë për me kerku shërbime mjekësore në shtëpi të shëndetit prej aty shumica ndalen aty pse me i hup dy herë makinës mu ndal rrugës e tu kane mu ndal aty ne nëse i ndihmojmë një biznesin 10-15 të tjerë jemi tu i shkel këtë duhet me ditë normal duhet mos me la hiq ke kush ke për me ju dhanë mundësi të barabarata të gjithë bizneseve ne komunën tonë, sepse me këtë po i dëmtojmë të tjerët.

**z.Basri Sylejmani:** Se atë dit kame qen kundër me e hek krejt tani shkoj debati ati dit si shkoj e ne nëse jemi për me dhanë më mirë është për 13 vite ose me hek krejt. Unë jam me hek krejt a për 7 vite as unë nuk jam unë jam për 13 vite.

**z.Ramadan Deliu:** Unë po propozoj, aty nuk ka i Begunces apo kush kanë të drejt me aplik kush të do unë jam për me e votu për 13 vite qite ne votim.

**z.Bekim Aziz, kryesues i kuvendit:** Vendimet qe i kemi marr me herët janë kthy të ligjshëm nga Ministria tash edhe këtë vendim e dërgojmë ne ministri, unë tash i kame dy propozime paravete, njëri 13 vite e tjetri 10 vjet unë e qes në votim propozimin e ekzekutivit me 13 vite. Kush është që të kalon propozimi prej 13 vite? Ju lutem me ngrite dore me 11 pro, 7 kundër, 1 abstenim. D.m.th kalon propozimi me 13 vite.

Si pikë të nëntë të rendit të ditës e kemi:

**9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen “qytetarë nderi” i Komunës së Vitisë, drejtoreshën ekzekutive të MCC-së z. Alice P. Albright**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar:** Rendi ka qenë me pajis me një biografi të personi në fjalë, megjithatë mungon ajo pjesë, po kemi të jem më vajzën e Medin Albright një personalitet, e cila ka kontribu shumë në lirinë e Kosovës dhe për momentin është shefe e MCC-së. Ju jeni dëshmitar edhe të asaj se, Komuna e Vitisë është një nder komunat e para përfituese e projektit në bashkëpunim me MCC dhe i ki dy objekte të cilët janë në përfundim të punimeve, prandaj kjo ka shpreh gatishmëri me ardh me e vizitu Kosovën, gjegjësisht Vitisë. Konsideroj që na bënë nder.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Hapi diskutimin.

**z.Ali Bajrami:** Isha ndërlidh me fjalët e nënkryetarit nëse na dalim e shofim angazhimin kontributin e MCC-se qe e ka dhanë në Komunën e Vitisë, është një punë e madhe qe është bë si MCC direkt me mjete financiare. Punë e fundit që e kemi e kemi këto dy objektet që janë investim i MCC. Ne si grup parlamentar jemi pro këtij propozim vendimi.

**z. Jakup Demiri:** Edhe ne si grup parlamentar jemi pro këtij propozim vendimi, vetëm qe kërkojmë herave tjetra edhe një biografi për këtë.

**z.Taulant Haxhiu:** Edhe ne si grup parlamentar jemi pro këtij propozim vendimi, duke e ditë kontributin e jashtëzakonshme qe kanë dhanë për Kosovën.

**z.Bekim Azizi kryesues i kuvendit:** Ne do ta shpallim qytetar nderi për vlerën e saj, vlerën e familjes së saj, kontributin për çështjen kombëtare qe ka dhanë për vendin tonë. Kërkoj me ngritje dore të votojmë. Me 20 vota pro, asnjë kundër, asnjë apstenim, miratohet kjo pik e rendit të ditës.

Si pikë të dhjet të rendit të ditës e kemi:

**10. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ngritjen e Obeliskut për z. Madeleine Albright**

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Materialin e keni marr, nëse ka për diskutim, hapi debat, nëse jo qes ne votim për miratim. Kush është për? 20 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim miratohet kjo pik e rendit të ditës.

Si pikë të njëmbëdhjetë të rendit të ditës e kemi:

**11. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit paraprak me nr. 01-110/05-477 të datës 04.05.2022, për shpalljen me interes të përgjithshëm për hapjen e rrugës së re në zonën kadastrale në Sllatinë.**

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Ministria e Planifikimit Hapësinor na ka thanë qe kjo procedurë duhet me udhëheq nga kryetari e nuk ka pas nevojë me nxjerr vendim, e për këtë e kemi pru shfuqizimin e vendimit që e kemi miratu ne. Tani hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Nexhat Halili:** Unë po e shof qe ky vendim është kthy dikun me 20.05.2022, pse nuk është pru në seancat e mëhershme. Jam në dijeni për këtë, sepse kemi pas diskutime në këtë vendim nuk po me pëlqen se shume vendime po na shkojnë ne ministri e po na kthehen mbrapa: a kemi zyre ligjore? Ne e dimë që kjo rrugë është tu punu, e ne tash e shfuqizojmë një vendim që puna vetëm ka hec.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Këshilltarët e dinë që, shumë herë kemi shpall kështu, po këtë herë për çudi kanë thanë jo në këtë formë po formën tjetër. Unë kame insistu që me pru vendimin me e shfuqizu përshaka se sanksionohet kuvendi. Drejtoresha ka shku ne ministri edhe ata i kanë thanë që duhet me vepru kështu.

**z.Jakup Demiri:** Ne jemi kanë kundër kësaj pike dhe ju kemi thanë pse jemi kanë kudër. Edhe Zyra Ligjore ka qenë dashur me ditë që, nuk është në rregull, ne do të abstenojmë në këtë.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Jakup, kjo pikë është votu nga të gjithë, shikoni procesverbalet.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Jakup, e kemi një Zyre Ligjore shumë funksionale, çdo kompliment dhe shumë bashkëpunuese, po nuk është rasi që na monitoron dikush këtu, nuk kemi të bëjmë më vendim që është jashtë ligjor, po na kanë thanë që nuk keni nevojë me shku në këtë mënyrë, po kryetari drejtpërdrejt me bë shpronësimin.

**z.Jakup Demiri:** Janë procesverbalet edhe shihen se sa vendime i kemi votu, sa e vërtet që i kemi votu kundër, 80% të vendimeve ashtu siç tha nënkryetari.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Kush është që kjo pikë të shfuqizohet me ngritje dore. 13 pro, 0 kundër, 7 abstenime, kalon edhe kjo pik e rendit të ditës.

Si pikë të dymbëdhjetë të rendit të ditës e kemi:

**12. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e kodeve të ri për projektet me participim**

**z.Naim Pira drejtor:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Para juve e kemi sjell një propozim vendim për krijimin e kodeve të reja me participim, kemi të bëjmë me projektet, ku ne si Drejtori e Bujqësisë të cilat i japim dhe kane participi qytetarët me parë nuk ka qenë praktikë që kuvendi të nxjerr kode të rinj, po lidhur me Ligjin për Ndarjen Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 thuhet në mënyrë dicitive, andaj kërkoj nga ju që të miratohet ky propozim vendim, po vetëm po ju njoftoj që, është bë një gabim këtu tek tabela që e kemi formulu, tek dyshi është bë një gabim teknik. Në vend të 17975 e kemi pru 17795. Ju kisha lut që sekretaria ta rregullon dhe pjesa e participimi ka gabim, e kam njoftu sekretarin që ta rregullon.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Hapi debat.

**z.Ali Bajrami:** Drejtor, faleminderit për shpjegimin që si propozim vendim është që të votohet dhe të kryhen obligimet ndaj operatorëve. Ne si grup parlamentar jemi pro.

**z.Jakup Demiri:** Edhe ne si grup parlamentar jemi pro.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim me përmirësim që i dha drejtori. Me 21 pro, 0 kundër, 0 abstënim miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të trembëdhjetë të rendit të ditës e kemi:

**13. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik draft Strategjinë e Zhvillimit Lokal 2022-2026**

**z.Bekim Azizi, kryesuesi:** Zyra e zhvillimit ka përgatit planin që një kohë të gjatë. Për shkak të materiali nuk e kam prurë në seancë, po ju dërgojmë ne email. Këtë do ta votojmë për diskutim publik. Kush është që të miratohet kjo pikë? Me 21 pro, 0 kundër, 0 abstënim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pike të katërbëdhjetë të rendit të ditës kemi:

**14. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në shqyrtim publik projekt Planin e Zhvillimit Komunal të komunës së Vitisë 2022-2030**

**z.Visar Demiri, drejtor:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Para juve kemi propozim vendimi për shpalljen ne shqyrtim publik të Projekt Planin e Zhvillimit Komunal të Vitisë për vitin 2022-2030. Ky plan do te jepet ne diskutim publik deri me datën 31.10.2022. Materialin e kemi marr me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Hapi debat për këtë pikë. Kush është që të miratohet kjo pikë? Me 21 pro, 0 kundër, 0 abstënim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të pesëmbëdhjetë e rendit të dite kemi:

**15. Informatë lidhur me raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me datën 31.12.2021**

**z. Besnik Imeri drejtor I financave:** Duke u bazuar ne Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi para juve kemi paraqitur Informatë lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar me datën 31.12.2021. Materialin e kemi pranuar me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Hapi debat për këtë pikë.

**znj.Liridona Bislimi:** Sa i përket një informate lidhur me raportin e auditimit për pasqyrat financiare, të komunës së Vitisë për vitin 2021, siç e ndëgjuam edhe ne ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre 9 janë të reja, 3 të përsëritura dhe 1 pjesërisht e përsëritur. Pra nga kjo na bënë të kuptojmë se ky vit për të cilën po diskutojmë del të jete brenga trendit tërësisht negativ që ka përcjell komunën, por edhe nga vitet e kaluara, refuzimi për të krijuar një sistem të brendshëm llogaridhënie të menaxhimit të burimeve financiare të komunës, flet për mungese totale të vullnetit për të menaxhuar drejt me pasurit e komunës, parregullsitë që e kemi lexu ne këtë raport janë të përsëriturat e të lejuara nga kreu i ekzekutivit të kësaj komune. Nuk munde të ketë shpjegim tjetër për një gjetje të tillë kur shihet qartas që janë shkeljet e vendimet. Mungesa e zbatimit të dispozitave ndëshkuese, disiplinore për zyrtarët që kryen shkelje, mungesa e vullnetit nga ana e organeve të ndjekjes penale për të hetuar zyrtar e gjykuar dëmet financiare, po thuaja se në shumicën e kategorive programeve po i inkurajon papërgjegjësinë e menaxhimit të financave të Komunës së Vitisë. Në këtë raport i kemi pothuaj të gjitha natyrat e shkeljeve dhe keq menaxhimit, duke filluar nga keq menaxhimi ku shpenzimet kontigjente nuk planifikohen siç duhet, dhe po shohim nga trajtimet ligjore që komunës për raportin financiar e për projektet kapitale, pastaj dobësia ne planifikimin të buxhetit ne kategorinë e ndarjes se subvencioneve dhe

s'pasoj kryetari i komunës bën dhënien e subvencioneve për të gjithë drejtuesit e njëjtë të dyshuar me shume se një her brenda viti edhe ata pa thirrje publike, kemi shkelje edhe tek administrimi i burimeve njerëzore te angazhuar me kontrata të quajtura me marrëveshje të veçanta pa i ndjekur procedurat ligjore, procedura e prokurimit dhe dhënien e kontratave pa emërtuar mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të kantatës është e kundërligjshme, kemi edhe disa shkelje të tjera që janë cekur këtu.

**z.Musli Neziri:** Unë çka kërkoj sot, tu e pas parasysh informatën, kërkoj që të ketë një menaxhim sa më të përgatitur, që mos të përsëriten këto shkelje që janë than në raport.

**z.Ali Bajrami:** Te plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, është obligim, ligj që rekomandimet e gjetura që mos të përsëriten dhe të evitohen në pasqyrat vjetore gjatë auditimit të vitit vijues, vitet e mëparshëm kanë qenë më shumë rekomandime. Jemi tu ardh çdo vit tu i zvogëlu rekomandimet sa i përket të gjeturave. Ne faqen nr. 3 kemi opinionin i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Unë mu pajtu me juve Liridonë jo, auditori i jashtëm nuk është i Komunës se Vitisë, nuk ka ndikim tek ai, ai e jep notën me të lartë, e normal që i ka gjetë disa gabime të vogla nga 38 komuna të Kosovës në mesin e 9 komunave që e kemi marr këtë opinion të pamodifikuar është edhe Komuna e Vitisë dhe ti thua fillon vit negativ për këtë nuk muj mu pajtu me juve Liridona. Unë nuk po i kontestoj të gjeturat.

**z.Nexhat Halili:** Tek pika nr.3 mangnesit në përmbylljen e procedurave të prokurimit rregullimi i fushave sportive në Komunën e Vitisë në vlerë 424 mijë 176 euro, zyrtari kryesor administrativ kishte emëruar menaxherin e kontratës po jo edhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejt te menaxhimit të kontratës. Kjo nuk është diçka, po zotimi i mjeteve është 50 mijë euro, a kontrata 424 mijë euro edhe zotimi i mjeteve është be pasi është nënshkru kontrata nënkryetar. Më së pari duhet mu bë zotimi i mjeteve nëse nuk kemi zotim të mjeteve, i ke ndarjen buxhetore, e tani procedurat tjera. Nënkryetar, ki numër të madh të punësuarve me kontratë mbi vepër.

Si pikë të gjashtëdhjetë të rendit të ditë kemi:

#### **16. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditorit për vitin 2021**

**z.Besnik Imeri, drejtor I financave:** Disa prej veprimeve që I ka dhanë auditori janë ndërmarr me këtë plan. Të gjitha rekomandimet do ti marrim me seriozitet dhe do të bëjmë përpjekje që të kemi sa më pak rekomandime vinin e ardhshëm.

**z.Bekim Azizi kryesues i kuvendit:** Ju faleminderit për kontributin e dhënë. Me kaq përfundojmë punimet të kësaj mbledhje. Shihem në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 15:30 min.

**Procesmbajtësi:**

**Fatlum Demiri**



**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**

**Bekim Azizi**

